# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5744
E enjte, 4 prill 2019
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuza ndaj 1 773 personave

FAQE 7




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", ASTRIT HARAQIJA FAQE 4-5

# Haziri, Sejdiu, Shala dhe Veliu, kandidatët kryesorë për kryetar të LDK-së

Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Astrit Haraqija, ka treguar se kush mund të jenë pretendentët kryesorë për postin e kryetarit të LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Lutfi Haziri, Fatmir Sejdiu, Kujtim Shala dhe Agim Veliu janë katër kandidatët që i kanë gjasat më të mëdha për ta drejtuar LDK-në. Ai e ka mohuar mundësinë që kryetari aktual i LDK-së, Isa Mustafa, t'i hyjë kësaj gare, siç ka thënë ai, që të "koritet në pleqëri". Haraqija nuk beson se në këtë proces LDK-ja do të përçahet sikurse në vitin 2006. Gjithashtu, Haraqija ka bërë me dije se do të angazhohet në politikë, duke u bërë pjesë e procesit zgjedhor të LDK-së në Gjakovë

## Haradinaj: Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizim, nuk përbën rrezik për migrim

FAQE 3



Republika e Kosovës i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe nuk përbën asnjë rrezik për migrim. Kështu ka deklaruar të mërkurën kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, gjatë një takimi me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. Kryeministri ka theksuar se statistikat e fundit tregojnë se ka rënë numri i qytetarëve të Kosovës që kanë migruar jashtë vendit. Sipas tij, në vitin 2018 kanë qenë vetëm 723 kërkesa për migrim

## Veprimtari Bali Dervishi ishte i pathyeshëm në idealin kombëtar

FAQE 7



## AKTUALE

### SKANDALI DHE STANDARDI F. 11



Shkruan: Iljasa SALIHU

### KËRKOHET QË ORËT E HUMBURA GJATË GREVËS TË ZËVENDËSOHEN F. 6

### FSK-ja ANGAZHOHET PËR SHUARJEN E ZJARREVE NË SKENDERAJ DHE PRISHTINË F. 7

## EKONOMI

### BIZNESET KËRKOJNË PËRFSHIRJE MË TË MADHE PËR HARTIMIN E POLITIKAVE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË F. 9

### QEVERIA E KOSOVËS: RAPORTI I BANKËS BOTËRORE, I PAVËRTETË F. 8

## KULTURË

### NGA MODELE NË KËNGËTARE F. 11



## SPORT

### LLAPI TREGON FORCËN NDAJ FERIZAJT, RIKTHEHET NË VENDIN E DYTË F. 14

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Bushati: Dorëzimi i mandateve të opozitës, i paprecedent

TIRANË, 3 PRILL - "Dorëzimi i mandateve të opozitës i paprecedent edhe për Venezuelën", ka deklaruar të mërkurën në Kuvend deputeti i Partisë Socialiste, Ditmir Bushati, ndërsa ka mbështetur propozimin e Damian Gjiknurit për të bashkëpunuar me opozitën për reformën zgjedhore.
Në fjalën e tij në Kuvend, Bushati tha se "raportimi i institucioneve që japin llogari para Kuvendit është normale, por në situatën që ne jetojmë, qoftë raportimi i KQZ-së, apo debate të natyrave të ndryshme që u shfaqën në lidhje me përmirësimin e sistemit zgjedhor, sot marrin një vëmendje të posaçme". "Politika shqiptare për herë të parë është në një situatë të paprecedent, përgjithësisht kemi qenë shpesh në rrethrrotullime, kemi gjetur tabelën për të dalë, por për herë të parë në historinë e pluralizmit të Shqipërisë dy parti parlamentare kanë dorëzuar mandatet e tyre, mandatet e dhëna nga populli. Normalisht është një situatë e paprecedent jo vetëm për demokracitë e reja në Evropën Jug Lindore, por edhe për vende me regjime despotike siç është rasti i Venezuelës. Nuk ka një mendje racionale qoftë shqiptare apo ndërkombëtare për ta legjitimuar djegien e mandateve si instrument politik për të arritur një objektiv të caktuar, qoftë rrëzimin e qeverisë, rrëzimin e një kryeministri apo provokimin e zgjedhjeve të parakohshme", theksoi ai.
Bushati më tej theksoi faktin se parlamenti është legjitim dhe zgjedhjet e 2017-s u organizuan në një qeveri të përbashkët pozitë-opozitë dhe të certifikuara nga OSBE/ODIR. "Aq më tepër kur ky kuvend u konstatua në zgjedhjet e 2017-s të cilat u organizuan nga një qeveri e përbashkët dhe institucionet kyçe u drejtuan nga opozita. Ky kuvend u pranua pas zgjedhjeve të 2017-s edhe nga opozita. Është ky Kuvend që ka marrë certifikatën e OSBE/ODIR dhe të gjithë e kemi pranuar se këto institucione janë autoriteti i padiskutueshëm për sa iu përket standardeve zgjedhore", tha Bushati.



# Palmer: Marrëveshja Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke

Zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ka thënë se Shtetet e Bashkuara besojnë se interesat e Kosovës dhe të Serbisë do të arrihen më së miri përmes një marrëveshje dypalëshe që do të çonte në një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve të përqendruara në njohjen reciproke



PRISHTINË, 3 PRILL - Zëvendësi i ndihmësit të sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, sugjeroi se është koha për arritjen e marrëveshjes në të mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe rikujtoi mesazhin e presidentit amerikan Donald Trump se negociatorët duhet ta shfrytëzojnë "mundësinë historike" për të arritur atë.
Matthew Palmer u bëri thirrje të dyja palëve që t'i shmangin hapat që e bëjnë kompromisin të vështirë. Po ashtu, Palmer theksoi se ShBA-ja nuk është pjesë e negociatave, por ajo mbështet fuqishëm dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE-së, për normalizimin e marrëdhënieve thelbësore për aspiratat e tyre evropiane. "Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje që është e zbatueshme, e qëndrueshme dhe nuk krijon paqëndrueshmëri në asnjë vend apo rajon. Ne do ta shqyrtojmë seriozisht çdo marrëveshje që i plotëson këto kushte", tha Palmer.
"I inkurajojmë të dyja palët ta udhëheqin plotësisht procesin, ta reduktojnë retorikën negative dhe të punojnë së bashku në mënyrë konstruktive drejt marrëveshjes. Serbia dhe Kosova janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme. Asnjëra palë nuk do të jetë në gjendje për të ecur përpara pa marrëveshjen e normalizimit të plotë", tha tutje Palmer.
Palmer përsëriti se Shtetet e Bashkuara i shohin Serbinë dhe Kosovën si dy shtete sovrane që kanë nevojë për të marrë vendime në interesin e tyre më të mirë. "ShBA-ja mbetet e angazhuar për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës si dhe partneritetin me Kosovën dhe Serbinë", tha Palmer. Ai tha se Shtetet e Bashkuara besojnë se interesat e Kosovës dhe të Serbisë do të arrihen më së miri përmes një marrëveshje dypalëshe që do të çonte në një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve të përqendruara në njohjen reciproke.

## Osmani: Presim vendim për bisedime në qershor

SHKUP, 3 PRILL - Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane të Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani, tha se ajo që Hahni e tha, e themi ne gjatë gjithë kohës, se pritjet tona janë që në qershor të kemi vendim për nisjen e bisedimeve. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve se deklarata e Hahnit ishte se nuk do të marrim datë për bisedime, por hyjmë në fazë përgatitore së bashku me Shqipërinë, ai tha se deklarata e Hahnit nuk ka qenë e tillë. "Nëse konventa ndërqeveritare do të mbahej në fund të vitit, pritet që kapitulli i parë do të hapej në janar. Këtë e sqaronte komisari Hahn, se në qershor s'do të thotë se menjëherë hapim kapitullin e parë. Në qershor merret vendimi për nisjen e bisedimeve këtë vit, e kapitulli i parë do të hapej në janar. Këtu jemi në të njëjtën linjë me komisionarit Hahn", tha Osmani.
Ai shtoi se nuk ka vendim për bisedime dhe se ky vendim do të merret në qershor. Sipas Osmanit, deri atëherë ka shumë çështje të paparashikuara, si BREXIT, zgjedhjet në Kuvendin Evropian. Osmani njoftoi se sot ka pasur takim me ambasadorin francez në Maqedoninë e Veriut, Christian Thimonier, i cili sapo ka ardhur nga Parisi dhe kanë biseduar për pozitën e Francës për këtë çështje.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, me të cilin ka biseduar për proceset nëpër të cilat po kalon vendi

# Haradinaj: Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizim, nuk përbën rrezik për migrim

Republika e Kosovës ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe nuk përbën asnjë rrezik për migrim. Kështu ka deklaruar të mërkurën kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, gjatë një takimi me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. Kryeministri ka theksuar se statistikat e fundit tregojnë se ka rënë numri i qytetarëve të Kosovës që kanë migruar jashtë vendit. Sipas tij, në vitin 2018 kanë qenë vetëm 723 kërkesa për migrim

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 PRILL - Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të mërkurën se shteti i Kosovës ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe nuk përbën asnjë rrezik për migrim. Ai ka deklaruar se statistikat e fundit tregojnë se ka rënë numri i qytetarëve të Kosovës që kanë migruar jashtë vendit dhe, sipas Haradinajt, në vitin 2018 kanë qenë vetëm 723 kërkesa për migrim. "Kisha kënaqësi të ndaj me ambasadorin Heldt statistikat e fundit reale të migrimit, ku Kosova tregon qartë se nuk përbën rrezik të migrimit, duke shënuar trendin më të vogël ndër vite me vetëm 723 raste të kërkesave për migrim në vitin 2018. Krahasuar me vitin 2015, ku shifrat e migrimit tregonin për 67 545 persona që kanë migruar, viti 2018 me vetëm 723 raste, tregon qartë një rënie prej 98 përqindësh, rezultat ky që dëshmon përkushtimin e qytetarëve të Kosovës, për të respektuar së pari shtetin e Kosovës, gjithashtu për t'i respektuar parimet bazë të lëvizjes së lirë", ka thënë Haradinaj pas takimit me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, me të cilin ka biseduar për proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë.

Kryeministri Haradinaj ka treguar se në këtë takim e ka informuar diplomatin gjerman se Kosova, përveç përmbushjes së kritereve për liberalizimin e vizave, ka shënuar përparim edhe sa i përket rendit dhe ligjit. Po në këtë takim shefi i Qeverisë së Kosovës ka shprehur përkushtimin për avancimin e marrëdhënieve bilaterale me Gjermaninë. "Në takimin e rregullt me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ndër të tjera, theksova se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave, ka shënuar përparim të konsiderueshëm në fushën e sigurisë, rendit dhe ligjit dhe është e përkushtuar t'i avancojë raportet bilaterale me Gjermaninë dhe gjithmonë e gatshme për marrëdhënie të mira me të gjitha vendet fqinje", ka theksuar kryeministri Ramush Haradinaj.

Migrimi ilegal llogaritet të jetë një nga shqetësimet kryesore të vendeve të Bashkimit Evropian, i cili pengon procesin e liberalizimit të vizave, madje ishte theksuar si pengesë edhe në rastin e shtetit të Kosovës. Ndërkohë, javën e kaluar, me 331 vota për, Parlamenti Evropian ka votuar pozitivisht një raport të përgatitur nga raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, i cili kishte të bënte me liberalizimin e vizave për Kosovën. Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor që të vazhdohet mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në Bashkimin Evropian (BE) do të mbahen në muajin maj.

Liderët institucionalë të Kosovës e kanë mirëpritur votimin pozitiv të Parlamentit Evropian, duke thënë se ky votim është argument i rikonfirmimit se Republika e Kosovës ka përmbushur të gjitha kriteret për heqjen e vizave për qytetarët e saj. Ndërsa raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, ka ftuar edhe një herë Këshillin Evropian që ta bëjë punën e vet në këtë proces. "Shumica kanë votuar në të mirë të liberalizimit të vizave për Kosovën. I bëjmë thirrje Këshillit Evropian të veprojë tani", ka shkruar Fajon në llogarinë e vet në "Twitter".



## Mustafa thotë se ende nuk ka kandidat për kryetar të LDK-së



PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, e ka quajtur të suksesshëm dhe demokratik procesin zgjedhor brenda kësaj partie. Ai ka thënë se ka një interesim të gjerë për anëtarësime të reja në LDK. "Zgjedhjet e brendshme në LDK synojnë forcimin e mëtejmë të kësaj Lidhjeje, që gëzon besimin më të madh në Kosovë. Po informohem çdo ditë se kemi një proces të suksesshëm dhe demokratik dhe një interesim të gjerë për anëtarësime të reja në LDK. Fokusimi ynë është në zgjerimin e LDK-së, në zgjedhje të suksesshme në nëndegë dhe në degë", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Megjithatë, ai ka thënë se kandidimet për kryetar të degëve dhe për kryetar të LDK-së do të bëhen në kuvendet e degëve, përkatësisht në atë qendror. Sipas Mustafës, tani LDK-ja nuk ka kandidat për kryetar e as kryetar në largim. "Kandidimet për kryetar të degëve dhe për kryetar të LDK-së, sipas statutit, do të bëhen në kuvendet e degëve, përkatësisht atë qendror të LDK-së. Tani LDK-ja nuk ka kandidat për kryetar e as kryetar në largim. Zgjedhjet i fillon dhe i kryen LDK-ja duke e respektuar vullnetin e shumicës. Ky vullnet do të dihet pasi të përmbyllet procesi në degë. Prandaj kandidatët i shpall LDK-ja duke respektuar vullnetin e çdonjërit. Do t'u isha mirënjohës gjithë atyre që e respektojnë këtë proces", ka deklaruar Mustafa.

Flet për "Epokën e re", Astrit Haraqija

# Haziri, Sejdiu, Shala dhe Veliu, kandid



**Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Astrit Haraqija, ka treguar se kush mund të jenë pretendentët kryesorë për postin e kryetarit të LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Lutfi Haziri, Fatmir Sejdiu, Kujtim Shala dhe Agim Veliu janë katër kandidatët që i kanë gjasat më të mëdha për ta drejtuar LDK-në. Ai ka mohuar mundësinë që kryetari aktual i LDK-së, Isa Mustafa, t'i hyjë kësaj gare, siç ka thënë ai, që të "koritet në pleqëri". Haraqija nuk beson se në këtë proces LDK-ja do të përçahet sikurse në vitin 2006. Gjithashtu, Haraqija ka bërë me dije se do të angazhohet në politikë, duke u bërë pjesë e procesit zgjedhor të LDK-së në Gjakovë**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 PRILL - Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Astrit Haraqija, ka bërë me dije se në zgjedhjet e brendshme të kësaj partie synon të zgjedhet kryetar i degës së kësaj partie në Gjakovë. Ai ka përmendur edhe katër pretendentët kryesorë për kryetar të LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Haraqija ka deklaruar se Lutfi Haziri, Agim Veliu, Kujtim Shala dhe Fatmir Sejdiu janë pretendentët kryesorë për të parin e LDK-së. "Secila prej kandidaturave të mundshme për kryetar të LDK-së, që janë përmendur nëpër medie, i ka vlerat e veta. Por, kandidat më serioz për kryetar të LDK-së mendoj se janë Lutfi Haziri, Fatmir Sejdiu, Kujtim Shala dhe Agim Veliu. Dike tjetër nuk e shoh tani që mund të ketë ambicie për kryetar të LDK-së. Në situatën aktuale që është brenda LDK-së, këto katër figura i shoh si pretendentët kryesorë për postin e kryetarit të LDK-së", ka thënë Haraqija.

Ai ka mohuar mundësinë që kryetari aktual i LDK-së, Isa Mustafa, të kandidojë sërish për të parin e LDK-së. "Si mundësi mund të jetë, por nuk besoj se do të ndodhë kjo. Besoj se z. Mustafa është shumë i dijshëm dhe nuk hyn në këtë lojë më. Pak e njoh, veç në bazë të veprimeve të tij, nuk besoj se hyn në këtë lojë, sepse një gjë e tillë nuk do të ishte mirë edhe për moshën që ka. Pra, nuk besoj se do të koritet në pleqëri", është shprehur ai.

Ish-zyrtari i lartë i LDK-së ka thënë se nuk do të përsëritet më në këtë subjekt politik Kuvendi i vitit 2006. Sipas tij, mund të ndodhë largimi i ndonjë individi të pakënaqur, por nuk mund të ketë përçaje. "Mund të largohet ndonjë individ i pakënaqur, por nuk do të ketë përçaje të LDK-së. Kjo parti nuk është krahinore dhe nuk i takon vetëm një grupi. Për shembull grupit të Llapit, të Gjilanit apo të Dukagjinit. LDK-ja është e gjithë Kosovës dhe besoj se ka aq njerëz të aftë që nuk do të lejojnë të përsëritet Kuvendi i vitit 2006", është shprehur Haraqija.

**"Epoka e re":** *Z. Haraqija, zgjedhjet e brendshme në LDK janë shpallur. A do të jeni pjesë e këtij procesi zgjedhor?*

**Haraqija:** Në LDK zgjedhjet edhe kanë filluar edhe nuk kanë filluar. Kjo punë është 50 me 50. Diku po thonë se kanë filluar zgjedhjet e diku tjetër ende. Nuk po dalin me deklaratë për këtë punë, por po e mbajnë si të fshehtë. Unë besoj se zgjedhjet e LDK-së do të fillojnë dhe do të përfundojnë në muajin maj. Natyrisht se do të jem pjesë e këtij procesi.

**"Epoka e re":** *Kush po mundohet ta mbajë të fshehtë këtë proces zgjedhor?*

**Haraqija:** Ata që vendosin për këtë punë. Unë ende nuk e kam dëgjuar dikë publikisht që thotë se është hapur procesi. Po thuhet se një degë i ka hapur zgjedhjet, kurse një degë tjetër nuk i ka shpallur ato. Zgjedhjet duhet të shpallen me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të cilin e propozon Kryesia e LDK-së. Mirëpo, deri më sot zyrtarisht nuk e kam parë një gjë të tillë. Megjithatë, aq sa kam dëgjuar nëpër medie, zgjedhjet e brendshme kanë filluar nëpër disa degë.

**"Epoka e re":** *Ku do të inkuadroheni ju dhe çfarë synoni?*

**Haraqija:** Do të filloj nga nëndega e shtatë e Degës së LDK-së në Gjakovë. Kjo është nëndega më e madhe në këtë komunë. Aty do të synoj të zgjedhem kryetar i Degës së LDK-së në Gjakovë.

**"Epoka e re":** *A besoni se do t'ju përkrahë elektorati i LDK-së në këtë komunë?*

**Haraqija:** Natyrisht se po. Jam në komunikim të përditshëm me elektoratin. Unë libra nuk shkruaj, por me elektorat merrem çdo ditë. Edhe pse jam opozitë e Degës së LDK-së dhe opozitës në qendër të LDK-së, prapëseprapë me elektoratin

# atët kryesorë për kryetar të LDK-së



dhe aktivistët e kësaj partie kam kontakte të rregullta.

**"Epoka e re":** *Siç dihet, ju nuk i keni raportet e mira me udhëheqësinë qendrore të LDK-së. Sa mund t'ju pengojë kjo në këtë proces?*
**Haraqija:** Unë nuk i kam raportet keq me askënd. Pse ata kritikat e mia i marrin personale, atëherë është problem i tyre, jo i imi. Unë jam me frymën rugoviane për të bashkuar njerëz dhe jo për të larguar. Kur po mund të flasim me Listën Serbe dhe me të tjerët, pse nuk mund të flasim mes vete. Nuk e kam të qartë këtë.

**"Epoka e re":** *Si e parashihni të shkojë procesi zgjedhor në LDK?*
**Haraqija:** Udhëheqja aktuale e kësaj partie duhet ta ketë të qartë se LDK-ja është akademi për partitë e tjera politike. Prej kësaj partie varen të gjitha zhvillimet e tjera. LDK-ja është parti institucionale dhe është parti për ta ruajtur shtetin, e jo sikur po vepron tash. Edhe me presidentin Rugova kur i kemi fituar zgjedhjet, kurrë prej parlamenti nuk kemi dalë dhe kurrë nuk e kemi sabotuar parlamentin. Pavarësisht se kush është në krye të institucioneve shtetërore ne duhet t'i ruajmë ato. Ndërsa teket individuale dhe hidhërimet brenda natës nuk më bëjnë përshtypje. Ashtu siç ka thënë presidenti Rugova: ne elektorin e kemi të mirë, po ne udhëheqja jemi të këqij.

**"Epoka e re":** *Tashmë, disa zyrtarë të lartë të LDK-së i kanë shpallur edhe kandidaturat për kryetar të LDK-së. Si i keni parë këto kandidatura?*
**Haraqija:** E kam parë se dikush publikisht ka folur për pretendime për kryetar të LDK-së, por dikush po thotë se ende nuk i kanë prezantuar në kryesi të partisë zyrtarisht ato kandidatura. Çdokush ka të drejtë ta synojë këtë post, por nuk do të thotë tash të dalin 50 kandidatura, sepse nuk është logjike kjo. Besoj se do të ishte mirë edhe për demokracinë e brendshme dhe për partinë që t'i kemi tri ose katër kandidatura. Edhe në vitin 2006 kanë qenë dy kandidatë. Nuk do të duhej të ishte vetëm një kandidat për kryetar të LDK-së.

**"Epoka e re":** *Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka deklaruar publikisht se do të kandidojë për të parin e LDK-së. Po ashtu, ish-kryetari i kësaj partie, Fatmir Sejdiu, e ka lënë të hapur këtë mundësi. Por mediet si kandidate të mundshme kanë përmendur deputeten Vjosa Osmani. Cilin prej zyrtarëve të lartë të kësaj partie e shihni favorit për kryetar?*
**Haraqija:** Secila prej kandidaturave të mundshme për kryetar të LDK-së që janë përmendur nëpër medie i ka vlerat e veta. Por kandidatë më seriozë për kryetar të LDK-së mendojnë se janë Lutfi Haziri, Fatmir Sejdiu, Kujtim Shala dhe Agim Veliu. Dikë tjetër nuk e shoh tani që mund të ketë ambicie për kryetar të LDK-së. Në situatën aktuale që është brenda LDK-së, këto katër figura i shoh pretendentët kryesorë për postin e kryetarit të LDK-së.

**"Epoka e re":** *Cila prej këtyre katër figurave mendoni se i ka gjasat më të mëdha për ta marrë këtë post?*
**Haraqija:** Prej 300 mijë anëtarëve të LDK-së t'i sjella katër figura. Tash mos më bëj presion me t'i përmend edhe dy figura. Punët e mëdha nuk kryhen brenda ditës.

**"Epoka e re":** *Asnjëherë nuk është përjashtuar mundësia që edhe Isa Mustafa të kandidojë sërish për të parin e kësaj partie?*
**Haraqija:** Si mundësi mund të jetë, por unë nuk besoj se do të ndodhë kjo. Besoj se z. Mustafa është shumë i dijshëm dhe nuk hyn në këtë lojë më. Pak e njoh, veç në bazë të veprimeve të tij, nuk besoj se hyn në këtë lojë. Një gjë e tillë nuk do të ishte mirë edhe për moshën që ka dhe nuk besoj se do të koritet në pleqëri.

**"Epoka e re":** *Meqenëse postin e liderit të LDK-së po e synojnë shumë individë, pritjet e konkurrenteve politikë të kësaj partie janë që ky proces mund ta përçajë LDK-në sikurse ka ndodhur më herët. Mund të përsëritet Kuvendi i vitit 2006?*
**Haraqija:** Nuk besoj se do të ketë asi rivaliteti që do ta çojë partinë në një përçarje të re. Vazhdimisht ka pasur largime prej LDK-së. E mbaj mend kohën kur është larguar grupi i të burgosurve politikë, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri dhe grupe të tjera. LDK-ja është shtëpi e madhe dhe nuk besoj se mund të ndodhë përsëri ajo që ka ndodhur në Kuvendin e vitit 2006. Mund të largohet ndonjë individ i pakënaqur, por nuk do të ketë përçaje të LDK-së, sepse kjo parti nuk është krahinore dhe nuk i takon vetëm një grupi. Për shembull grupit të Llapit, të Gjilanit apo të Dukagjinit. LDK-ja është e gjithë Kosovës dhe besoj se ka aq njerëz të aftë që nuk do të lejojnë të përsëritet Kuvendi i vitit 2006.

**"Epoka e re":** *Për t'i ikur një përplasje të mundshme të grupeve brenda LDK-së, Lutfi Haziri ka propozuar që për kryetar të LDK-së të ketë një marrëveshje politike brenda partisë. E shihni të mundshme këtë?*
**Haraqija:** Kjo besoj se është normale. Çdo kund në botë, edhe në CDU, ka opozitë brenda një partie. Kur një parti ulet e negocion me partitë e tjera politike, pse mos të negociojë edhe me fraksionet e mundshme brenda saj. Është e mundshme kjo. Bile do të ishte shumë mirë që të ndodhte një marrëveshje që të kuptohet se kush është i pari, kush i dyti dhe kush është i pesti.

# Coppola: Misioni i EULEX-it për ta ndihmuar Kosovën vazhdon të jetë i pandryshuar

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Komandanti i Operacioneve Civile të BE-së, Vincenzo Coppola, ka vizituar Kosovën më 2 dhe 3 prill. Ai gjatë kësaj vizite është takuar me presidentin Hashim Thaçi, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, si dhe me përfaqësuesit e nivelit të lartë të organizatave ndërkombëtare dhe me ambasadorët e Shteteve Anëtare të BE-së në Kosovë.

Gjithashtu, ai pati takime me shefen e misionit EULEX-it, Alexandra Papadopoulou dhe me drejtuesit e lartë të këtij misioni. "Kjo është vizita ime e dytë në Prishtinë në cilësinë time si Komandant i Operacioneve Civile që vjen pas vizitës së parë njohëse gjatë dhjetorit të kaluar. Unë pata kënaqësinë ta takoj për herë të parë presidentin Thaçi dhe të takohem sërish me kryeministrin Haradinaj dhe zyrtarë tjerë të lartë të rëndësishëm të Kosovës si dhe me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare", ka thënë Coppola. Ai ka theksuar se këto takime i ofruan atij një mundësi të mirë për ta vlerësuar së bashku me homologët kryesorë stadin e zbatimit të mandatit të tanishëm të EULEX-it pas përfundimit të rikonfigurimit të këtij misioni në mesin e muajit dhjetor të vitit të kaluar. "Ndihma e EULEX-it për partnerët e tij kosovarë ka ndryshuar si rezultat i mandatit të tij të ri për vitet 2018-2020, por përkushtimi i këtij misioni për t'i ndihmuar autoritetet e Kosovës për fuqizimin e sistemit të saj të sundimit të ligjit vazhdon të jetë i pandryshuar", ka thënë Coppola.

Komandanti i Operacioneve Civile e ushtron komandën dhe kontrollin në nivel strategjik për planifikimin dhe realizimin e të gjitha misioneve civile të politikës së përbashkët të BE-së për siguri dhe mbrojtje në mbarë botën, duke përfshirë edhe EULEX-in.



## OVLUÇK-ja nderon me mirënjohje sekretarin e përgjithshëm të MSh-së, Naim Bardiqin

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe sekretari i kësaj organizate, Faton Klinaku, nderuan të mërkurën me mirënjohje për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare dhe vetëmohimin e jashtëzakonshëm në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Naim Bardiqi.

Gjatë një takimi në Ministrinë e Shëndetësisë, krerët e OVLUÇK-së shprehën falënderimin e tyre për angazhimin e sekretarit Bardiqi për t'i ndihmuar anëtarët e kësaj organizate në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Nga ana e tij, sekretari Naim Bardiqi është shprehur falënderues për mirënjohjen e ndarë dhe ka theksuar se për të ka qenë obligim t'i shërbejë vendit në ditët më të vështira të historisë së tij.

Gjatë vizitës në ministri të Shëndetësisë, krerët e OVLUÇK-së i ka takuar edhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i cili i ka njoftuar ata për angazhimet e ministrisë për sigurimin e shërbimeve shëndetësore sa më cilësore dhe të sigurta për veteranët e luftës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.



# Kërkohet që orët e humbura gjatë grevës të zëvendësohen



**Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, Komisioni Parlamentar për Arsim dhe Përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve, kanë shprehur të mërkurën edhe një herë qëndrimin se orët e humbura gjatë grevës duhet të zëvendësohen**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me ftesë të Komisionit Parlamentar për Arsim, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e SBAShK-ut dhe përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të Prishtinës, mori pjesë në takimin e radhës dhe, pas diskutimeve të shumta, Komisioni unanimisht ka kërkuar nga përfaqësuesit e SBAShK-u që të bartin në Këshillin Drejtues zotimin për përmbushjen e kërkesave dhe të dalin me një qëndrim, i cili do të çonte drejt një marrëveshje për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës. Me këtë rast, ministri Bytyqi u shpreh i hapur për bashkëpunim, për arritjen e një marrëveshjeje e cila do të mundësonte kompensimin e orëve të humbura.

Bazuar në propozimet e deputetëve për ndryshimin e formulës së zëvendësimit të orëve, ministri Bytyqi shprehu edhe një herë gatishmërinë për ta anuluar formën aktuale të zëvendësimit të orëve dhe për t'u hapur rrugë propozimeve të reja dhe një formule të re, e cila garanton zëvendësimin e orëve të humbura gjatë grevës, me të cilën do të pajtohej paraprakisht edhe SBAShK-u.

Nga ana tjetër, kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi, ka vlerësuar këtë gatishmëri të ministrit Bytyqi, për të dalë me një formulë të re e cila do të ishte e pranueshme me të gjitha palët. Gjithashtu, Kurteshi shprehu zotimet e tij dhe të Komisionit për Arsim për t'i filluar procedurat për plotësim-ndryshimin e Ligjit për paga pasi ai të hyjë në fuqi.

U konstatua se dy kërkesat e SBAShK-ut do të plotësohen, në të njëjtën kohë u kërkua nga përfaqësuesit e SBAShK-ut që të dalin me një qëndrim të ri përkitazi me situatën e re të krijuar, pas gatishmërisë së ministrit për të gjetur një formulë të re për kompensimin e orëve dhe zotimit të deputetëve për ta mbështetur inicimin e procedurave ligjore për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Paga për ngritjen e koeficientit të mësimdhënësve të nivelit fillor, klasa 1 deri 5.

Në këtë takim ministri Bytyqi, Komisioni Parlamentar dhe Përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve shprehen edhe një herë qëndrimin se orët e humbura gjatë grevës duhet të zëvendësohen.

## Oda e Mjekëve nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Inspektoratin Shëndetësor

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Në zyrat e Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK) është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është zyrtarizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë institucional për të siguruar një mbikëqyrje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, sigurimin e integritetit profesional të mjekut si profesionist shëndetësor, forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke mbrojtur kështu edhe interesat e pacientëve që janë përfitues të shërbimeve shëndetësore.

Kjo marrëveshje është formalizim i bashkëpunimit të deritanishëm të OMK-së dhe Inspektoratit Shëndetësor, ku në kuadër të kësaj marrëveshjeje planifikohen të bëhen edhe inspektime të përbashkëta ndërmjet institucioneve gjegjëse OMK-së dhe Inspektoratit Shëndetësor. Me këtë rast, kryetari i OMK-së, dr. Pleurat Sejdiu, ka vlerësuar gatishmërinë për bashkëpunim të Inspektoratit Shëndetësor, ku falënderoi dr. Ardita Barakun, kryeinspektoren e Inspektoratit Shëndetësor, me zotimin se do të punojnë së bashku për forcimin institucional të sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës.



# Veprimtari Bali Dervishi ishte i pathyeshëm në idealin e tij kombëtar

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Lëvizja Shoqëria kanë organizuar të mërkurën akademi përkujtimore kushtuar veprimtarit Bali Dervishi me rastin e pesëvjetorit të vdekjes së tij. Në këtë akademi përkujtimore është thënë se veprimtari Bali Dervishi ishte njeri i pathyeshëm në idealin e tij kombëtar




EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 3 prill** - Nën organizimin e Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Lëvizjes Shoqëria, në Institutin Albanologjik të Prishtinës të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimore kushtuar veprimtarit Bali Dervishi me rastin e pesëvjetorit të vdekjes së tij. Në këtë akademi përkujtimore morën pjesë përfaqësues të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, të Lëvizjes Shoqëria, përfaqësues të Komunës së Vushtrrisë, profesorë universitarë, bashkëveprimtarë të Bali Dervisht dhe familjarë të tij.

Hydajet Hyseni, kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, ka thënë se veprimtari Bali Dervishi ishte bashkues, i dashur dhe qortues për të mirën e kombit. "Ai ishte shumë i dashur. Dinte edhe të na qortonte që mos të gabonim", ka thënë Hyseni, duke shtuar se bashkimi na duhet edhe tani. "Një bashkim që na këndell dhe që na shtynë përpara. Jam i bindur se kjo edhe do të ishte porosia e Bali Dervishit", ka thënë Hyseni.

Tahiri Krasniqi, kryetar i Degës së Shoqatës së të Burgosurve Politikë në Vushtrri, ka theksuar se emri i Bali Dervishit është i respektuar jo vetëm për vitet e gjata që i kishte mbajtur në burg (13 vite), por edhe për angazhimin e tij të pandalshëm për çlirimin e Kosovës nga okupatori serb.

Krasniqi ka thënë se veprimtari Bali Dervishi sa ishte në krye të Degës së Shoqatës së të Burgosurve Politikë në Vushtrri bënte punë të palodhshme, ndihmonte familjet e të burgosurve dhe ishte parimor. "Fjala e tij ishte largpamëse dhe shpirti i tij ishte i pathyeshëm për idealin për bashkimin kombëtar", ka thënë Tahir Krasniqi.

Meriman Braha, ish i burgosur politik, në fjalën e tij ka evokuar kujtime në kohën sa ishte në burg së bashku me të ndjerin, veprimtarin Bali Dervishi. Braha ka theksuar se veprimtari Bali Dervishi ishte angazhuar fuqishëm në ballë të demonstratave të '81-shit në Vushtrri dhe në mbarë Kosovën me kërkesën: Republikë. "Ai ishte unik. Ka qenë i kujdesshëm për shokët. Balia ka pasur një sistem të mirë të afrimit, që mos të ndahemi. Bashkë rrinim dhe bashkë hanim bukë. Dhe mund t'ju them se rol të parë, të rëndësishëm në çdo aktivitet, ka pasur Bali Dervishi. Familja të jetë krenare dhe t'i ruajë kujtimet më të mira për të", është shprehur Braha.

Për një fjalë rasti në këtë akademi ka folur edhe Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, dhe nip i veprimtarit Bali Dervishi. Ai ka thënë se kur shikonte duart e dajës (Bali Dervishit) shihte vuajtjet e tij për vite në rrugëtimin për lirinë e Kosovës. Aliu në emër të institucioneve lokale të Komunës së Vushtrrisë ka falënderuar këtë gjeneratë veprimtarësh për punën e madhe që ka bërë për çështjen kombëtare.

Kurse veprimtari, ish i burgosur politik i vitit 1981, Gani Krasniqi, ka thënë se Baliu iu bë krah UÇK-së me të gjitha fuqitë e tij. "Ai thoshte se atdheu ka kuptim vetëm kur është i lirë dhe i bashkuar", ka theksuar Krasniqi. Ai ka treguar se Bali Dervishi ishte një nga organizatorët kryesorë të demonstratave të '81-shit në Vushtrri. "Thoshte se pa luftë nuk fitohet liria. I rrethuar nga tytat e policisë serbe ai kishte ngarkuar vajzën e tij, Afërditën, për ta ngritur flamurin kombëtar. Pra, përveç babës, dënohet me burg edhe vajza e tij në moshë të re", ka treguar Krasniqi.

Gani Krasniqi ka thënë se Bali Dervishi ishte i pathyeshëm në veprimtarinë e tij. "Bali Dervishi nuk ishte i thyer. Përkundër torturave çnjerëzore që i bëheshin, ai qëndronte me kokë lart i pathyeshëm", ka thënë Krasniqi, i cili ka vlerësuar angazhimin e Bali Dervishit në Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës. "Ai në terren ishte i palodhshëm, ishte shembull i mirë për anëtarët e tjerë të Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës", ka thënë Gani Krasniqi, ish i burgosur politik.

Në fund të kësaj akademie të pranishmit i ka përshëndetur vajza e veprimtarit të ndjerë Bali Dervishit, Afërdita Dervishi. "Në të gjitha situatat jetësore, pa marrë parasysh kishte a s'kishte bukë, kishte a s'kishte libra, kishim apo s'kishim me çka të shkonim në shkollë, babai im, Bali Dervishi, na mësoi se kurrë nuk duhet të dorëzohemi para pengesave që na ranë hise. Ai bashkë me nënën, Rrahimën, u kujdesën që edhe kur na mungonte çdo gjë, edhe kur na largonin nga shkolla, nga grupi dramatik, nga sporti, nga praktika, nga vallëzimi, si fëmijë të 'irredentistit' e 'armikut' të socializmit jugosllav, ata, pra, na mësuan se dinjiteti është e vetmja vlerë që mëson njeriun të ecë vertikalisht në jetë. Faleminderit babë që na mësove të ecim drejt! Faleminderit babë që na mësove se atdheu është mbi të gjitha! Në emër të familjes së Bali Dervishit ju falënderoj nga zemra që sot, bashkë me ne, ndamë kujtimin dhe nderimin për Bali Dervishin", ka thënë Afërdita Dervishi.







## FSK-ja angazhohet për shuarjen e zjarreve në Skenderaj dhe Prishtinë

**Prishtinë, 3 prill (ER)** - Për shkak të thatësisë dhe temperaturave të larta që po mbretërojnë këto ditë në vendin tonë, janë shpeshtuar ndezjet e pyjeve. Ekipet zjarrfikëse të FSK-së të martën dhe të mërkurën janë angazhuar në mbështetje të pushtetit lokal për shuarjen e zjarreve në malet e Llaushës, Rakinicës dhe të fshatit Qubrel, Komuna e Skenderajt dhe në fshatin Vranidoll, Komuna e Prishtinës.

Në këto operacione është angazhuar Njësia e Task Forcës e FSK-së, me 33 pjesëtarë dhe shtatë automjete, të cilët që nga dita e martë kanë arritur t'i shuajnë zjarret në pjesën më të madhe të pyjeve të këtyre anëve.

Të mërkurën operacioni për shuarjen e zjarreve po vazhdon në fshatrat Llaushë, Qubrel dhe Vranidoll. "Bëjmë apel te të gjithë qytetarët e Kosovës që të mos i ndezin mbeturinat dhe djerrinat sepse në këtë mot të thatë lehtë shkaktohen dëme në malet e Kosovës", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.



# Qeveria e Kosovës: Raporti i Bankës Botërore, i pavërtetë

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes një reagimi për media ka vlerësuar se raporti i publikuar të martën nga përfaqësuesi i Bankës Botërore në Kosovë, për sa i përket zvogëlimit të vendeve të punës në Kosovë në vitin 2018, për 17 mijë vende pune, është plotësisht i pavërtetë dhe i pabazuar



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 PRILL - Qeveria e Kosovës i ka konsideruar të pavërteta dhe të pabazuara, gjetjet e raportit të publikuar të martën nga Banka Botërore, në të cilin është thënë se vetëm në vitin 2018 tregu i punës në Kosovë është zvogëluar për 17 000 vende. "Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se raporti i publikuar dje nga përfaqësuesi i Bankës Botërore në Kosovë, për sa i përket zvogëlimit të vendeve të punës në Kosovë në vitin 2018, për 17 000 vende pune, është plotësisht i pavërtetë dhe i pabazuar. Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, por edhe Raporti Financiar për Shpenzimet e Buxhetit për vitin 2018, për zhvillimet makroekonomike në Kosovë flasin krejt ndryshe", është thënë në reagimin e Qeverisë së Kosovës.

Në këtë reagim thuhet se "nuk na befason paraqitja e përfaqësuesit të BB-së me këto shifra, por jemi befasuar me gatishmërinë e kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, me profesion ekonomist, profesor universitar dhe akademik, për shfrytëzimin e këtij informacioni, pa një analizë profesionale e kritike ashtu siç mendojmë se i takon". "E kuptojmë nevojën e kritikës së opozitës për Qeverinë, por jo me çfarëdo mjeti dhe nga çfarëdo niveli. Sipas të dhënave të publikuara së fundmi nga ASK lidhur me punësimin dhe strukturën e aktivitetit ekonomik të popullsisë, numri i të papunëve në vitin 2018 është zvogëluar për 11.611 persona, që do të thotë se shkalla e papunësisë është zvogëluar për një për qind në krahasim me vitin 2017", është theksuar në reagimin e Qeverisë.

Sipas Qeverisë së Kosovës, ecuritë makroekonomike në Kosovë në vitin 2018 ishin si vijon: norma e rritjes, shtimit, ekonomik 4.2 për qind; investimet publike, rritje 13.1 për qind; remitencat 6 për qind; punësimi në sektorin publik 5.2 për qind; investimet në sektorin privat 6.4 për qind. "Raporti në fjalë nuk e qartëson se cilat janë kriteret dhe metodologjia e përdorur për hartimin e një raporti me konstatimin përfundimtar se janë humbur 17 000 vende të punës dhe ne si Qeveri, menjëherë kemi kërkuar informacione të sakta se cili është burimi dhe cilat janë metodat e punës për mbledhjen dhe paraqitjen e këtyre shifrave", është thënë në reagimin e Qeverisë së Kosovës.

# Ministria e Infrastrukturës dhe KOSTT-i, marrëveshje bashkëpunimi

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), Pal Lekaj, ka pritur të mërkurën në takim kryeshefin ekzekutiv të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSST), Ilir Shala, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Me anë të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, parashihet të rregullohet mënyra e bashkëpunimit mes dy institucioneve sa i përket shtrirjes së rrjetit elektrik në brezin rrugor të rrugëve rajonale dhe autostradave të reja, të cilat janë në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), Pal Lekaj, ka pritur të mërkurën në takim kryeshefin ekzekutiv të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSST), Ilir Shala, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. "MIT dhe KOSTT me anë të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit rregullojnë mënyrën e bashkëpunimit mes dy institucioneve sa i përket shtrirjes së rrjetit elektrik në brezin rrugor të rrugëve rajonale dhe autostradave të reja, e të cilat janë në pronësi të MIT-së", është theksuar në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Sipas kësaj ministrie, Lekaj ka deklaruar se ky bashkëpunim krijon lehtësira për implementimin me kohë të projekteve nga të dyja institucionet e që shkojnë në të mirë të qytetarëve dhe projekteve infrastrukturore.

Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Ilir Shala, duke shprehur kënaqësinë për nënshkrimin e kësaj marrëveshje me rëndësi për të dyja institucionet, ka thënë se bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit do të mbetet i vazhdueshëm.

### MIT-ja financon ndërtimin e bulevardit të Kamenicës me një milion euro

Po ashtu, ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën ka pritur në takim kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e bulevardit në këtë komunë. Vlera totale e këtij projekti do të jetë një milion euro. Për vitin 2019 për këtë projekt Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka ndarë shumën prej 400 mijë eurosh, ndërsa shuma prej 600 mijë eurosh është planifikuar për vitin që vjen, në mënyrë që ky projekt të realizohet në tërësi. Lekaj ka deklaruar se ndihet mirë që kryetari Kastrati është insistues dhe korrekt në raport me nevojat e qytetarëve, duke i premtuar atij se mbështetja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit nuk do të mungojë edhe në të ardhmen për këtë komunë.

## Për 94 asete sa ishin në shitje konkurruan 148 ofertues

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën, në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 45, përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 94 asete sa ishin në shitje konkurruan 148 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 10 567 135 euro. "Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi i drejtpërdrejtë i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe për të gjithë qytetarët e interesuar që s'kanë qenë të pranishëm në sallë", është thënë në njoftimin për media të AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.



# Bizneset kërkojnë përfshirje më të madhe në hartimin e politikave në sektorin e shëndetësisë




Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, gjatë takimit me anëtarët e Komitetit të Kujdesit Shëndetësor të Odës Amerikane, ka theksuar se vazhdimi i komunikimit të mirëfilltë në mes të sektorit publik dhe privat në procesin e hartimit të politikave në shëndetësi është i rëndësisë primare për sigurimin e zbatueshmërisë së këtyre politikave në vend

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 3 prill** - Në takimin e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, dhe anëtarët e Komitetit të Kujdesit Shëndetësor të Odës Amerikane u diskutua rreth krijimit të një sistemi të sigurimeve shëndetësore, rëndësisë së tij në vend, si dhe nevojën për një përfshirje më të madhe të bizneseve për hartimin e politikave në këtë sektor.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, konsideroi se vazhdimi i komunikimit të mirëfilltë në mes të sektorit publik dhe privat në procesin e hartimit të politikave në shëndetësi është i rëndësisë primare për sigurimin e zbatueshmërisë së këtyre politikave në vend.

Ministri Ismaili ka potencuar se mungesa e një sistemi të sigurimeve shëndetësore ka rezultuar në kosto të larta për qytetarët, gjithashtu ka ndikuar edhe në vështirësimin e operimeve të institucioneve publike shëndetësore.

Në këtë drejtim ai ka theksuar se ministria që ai drejton tashmë është në faza të avancuara të hartimit të ligjit për sigurime shëndetësore i cili do ta rregullojë në mënyrë të drejtë këtë çështje.

Kryesuesi i Komitetit të Kujdesit Shëndetësor të Odës Amerikane, Armend Agani, ka thënë se Kosova ka nevojë për arsimim dhe trajnim të vazhdueshëm të punëtorëve shëndetësorë për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.

Agani ka falënderuar ministrin Ismaili për angazhimin e tij për rregullimin e sektorit të shëndetësisë, ndërsa ka kërkuar përfshirje edhe të sektorit privat në grupe punuese për hartimin e legjislacionit me ndikim të theksuar në operimet e tyre. Më tutje, anëtarët e Komitetit të Kujdesit Shëndetësor të Odës Amerikane theksuan nevojën e zbatueshmërisë së plotë të dispozitave të ligjeve aktuale si dhe vazhdimin e bashkëpunimit.

# Luftimi i krimeve ekonomike dhe financiare, prioritet i prokurorisë

**Prishtinë, 3 prill (ER)** - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, me të cilin ka biseduar për aspektet që ndërlidhen me parandalimin dhe luftimin e veprave penale të evazionit fiskal, dukuri këto që dëmtojnë në masë të madhe ekonominë e vendit. Gjatë këtij takimi ata kanë folur edhe për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka potencuar se prioritet kryesor i Prokurorit të Shtetit është luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, krimeve financiare dhe veprave të tjera penale, me ç'rast ka thënë se ATK-ja do ta ketë përkrahje të plotë në këtë drejtim.

Ndërsa drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se prioritet i tij është luftimi dhe parandalimi i evazionit fiskal dhe për këtë ai ka theksuar se është e nevojshme mbështetje nga Prokuroria e Shtetit. Lumezi e Murtezaj janë pajtuar që të angazhohen për shtimin e bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve, në funksion të rritjes së efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, krimeve ekonomike dhe financiare.



# Komuna e Fushë-Kosovës, aksion për pastrimin e mbeturinave

FUSHË-KOSOVË, 3 PRILL (ER) - Komuna e Fushë-Kosovës, konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, është duke vazhduar pastrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të ndryshme në qytet dhe në fshatra.
Gjatë këtij aksioni për pastrimin e mbeturinave, baltës, rërës dhe barishteve, në fokus ishin vendet që frekuentohen më së shumti gjatë fundjavës nga qytetarët, si: rruga që të dërgon deri te Kalaja e Harilaçit, pastaj rrugët e fshatit Sllatinë, duke përfshirë edhe Pishat e Sllatinës si dhe ura te fshati Vragoli.





# Ramosaj nderon dëshmorët në Deçan

DEÇAN, 3 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, së bashku me bashkëpunëtorë dhe kolonelin Avdyl Mushkolaj, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në nderim të heroit Artan Mehmetaj e Halit Coka, si dhe te varri i dëshmorit Mustafë Çekaj e Naim Turkaj. "Sot, me homazhe dhe vendosje të kurorave me lule nga i pari i komunës, Bashkim Ramosaj, nënkryetari Sami Cacaj, kolonel Avdyl Mushkolaj, zyrtarë komunalë, asamblistë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së nga Deçani dhe Gjakova, qytetarë të shumtë kanë përkujtuar heronjtë Artan Mehmetaj dhe Halit Coka në Kompleksin Memorial 'Dëshmorët e Kombit' në Gllogjan, dëshmorin Mustafë Çekaj në Irzniq dhe dëshmorin Naim Turkaj në fshatin Gramaqel. Rruga deri te liria kishte shumë sakrifica. Lavdi e përjetshme!", ka njoftuar Komuna e Deçanit.

# Filloi asfaltimi i rrugës Gurbardh-Dragobil

MALISHEVË, 3 PRILL (ER) - Në kuadër të investimeve kapitale dhe realizimit të projekteve për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në Komunën e Malishevës, të mërkurën ka filluar asfaltimi i rrugës që lidhë fshatrat Gurbardh dhe Dragobil, përkatësisht lagjen Pallanka.
Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge ishte i pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili i ka uruar banorët për këtë rrugë. "Uroj që banorët e këtyre dy fshatrave, si dhe të fshatrave të tjerë, pasi kjo rrugë shërben edhe si rrugë transite, ta gëzojnë rrugën e re, e cila shkurton për dhjetëra kilometra lidhjen mes dy fshatrave, në të njëjtën kohë lehtëson edhe lëvizjen e fshatrave të tjerë të Malishevës, të cilët lëvizin nëpër këtë rrugë, që lidhet edhe me qendrën komunale, por edhe me qytetet e tjera", ka thënë Berisha.
Rruga Gurbardh - Pallanka ka një gjatësi prej 850 metrash, me gjerësi prej 5.5 metrave. Kjo rrugë, përveç që lidh fshatrat Dragobil e Gurbardh, lidh edhe Mirushën dhe Burimin, si dhe është një lloj transiti, pasi fshatrat në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Malishevës mund ta shfrytëzojnë këtë rrugë për t'u lidhur në magjistralen Malishevë - Rahovec në drejtim të Prizrenit e të Gjakovës, sikur që lidhet edhe me rrugët që shkojnë në drejtim të Suharekës.





# Ahmeti zotohet për tejkalimin e premtimit për ndërtimin e çerdheve në kryeqytet

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se këtë vit do të hapen edhe disa çerdhe në kryeqytet. Ai ka thënë se kjo komunë i ka 15 çerdhe publike me kosto të përballueshme. Në këtë kontekst, Ahmeti ka thënë se do ta tejkalojnë premtimin e dhënë për ndërtimin e çerdheve në Prishtinë. "Prej vitit 2014 kemi hapur këto çerdhe të reja publike, me bazë në komunitet: Mat, Hajvali, Sofali, Arbëri, Besi dhe Kodra e Trimave. Sivjet hapen edhe në Tophane, Kalabri si dhe hapet edhe çerdhja e rindërtuar 'Yllkat', te blloku me kapacitet të dyfishuar për të vazhduar në Kolovicë, Bardhosh dhe Dardani (çerdhe e re). Tash do t'i nisim investimet në çerdhet e vjetra të komunës. Komuna e Prishtinës i ka mbi 15 çerdhe publike me kosto të përballueshme", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se pa kujdes cilësor me kosto të përballueshme nuk ka as zhvillim. "Në këtë mandat kemi premtuar katër çerdhe të reja e, si duket, deri në fund këtë premtim do ta tejkalojmë dyfish", ka theksuar Ahmeti.
Komuna e Prishtinës në fillim të kësaj jave ka hapur çerdhen "Milingonat" në lagjen "Kodra e Trimave" për 200 fëmijë të kësaj lagjeje.

# Skandali dhe standardi



Shkruan: Iljasa SALIHU

Aq të shpeshta janë bërë skandalet saqë, për fat të keq, skandali është shndërruar në standard.
Skandal është të përdhoset gjuha standarde, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të punësohesh mbi baza partiake, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të bëhesh këngëtare e famshme mbi baza të zhveshjes, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të respektohesh vetëm për interes, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është t'i kesh shpenzimet më të larta se të ardhurat, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është ta dashurojë gruaja burrin dhe në anën tjetër ta urrejë familjen e burrit, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që politikani t'i ketë dhjetëfish më të larta kursimet se të ardhurat, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që profesori të paktën dy libra në vit të mos i lexojë, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që analisti partiak të hiqet si analistë i pavarur, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që gratë të turpërohen të merren me sport dhe në anën tjetër të dalldisura skajshmërish të vallëzojnë nëpër dasma, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që shoqatat bamirëse të ndërtojnë shtëpi për të pastrehët dhe në anën tjetër politikanët të ndërtojnë shtëpiza të shtrenjta nëpër male, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është prania e nepotizmit nëpër organet shtetërore, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të injorohet njeriu i drejtë dhe parimor, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të udhëhiqen besimtarët prej udhëheqësve fetar, të cilët udhëhiqen prej nëntokës dhe liderëve partiak, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që mikun ta harrosh posa të lartësohesh në piramidën politike, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është t'i blesh gjykatësit dhe në rast akuzash t'i thoshe tjetrit se nëse janë të vërteta këto akuza, urdhëro më paditë në gjykatë, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është të ecësh me sukses në karrierë në sajë të dukjes dhe jo të dijes, por në të vërtetë sot kjo është standard.
Skandal është që në mungesë të frytshmërisë së trurit, ta shesësh trupin për një avancim, por në të vërtetë sot kjo është standard.

*(Gjithmonë ka përjashtime! Në rastin e këtij shtjellimi përjashtimet janë të rralla)*

# Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuza ndaj 1 773 personave




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Prokurori i Shtetit gjatë muajit mars të vitit 2019 ka ngritur gjithsej 1 661 aktakuza ndaj 1 907 personave për vepra të ndryshme penale. Në Departamentin e Krimeve të Rënda të prokurorive themelore janë ngritur 88 aktakuza ndaj 134 personave.
Ndërkaq, Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorive Themelore ka ngritur 1 573 aktakuza ndaj 1 773 personave për vepra të ndryshme penale.
Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë muajit mars 2019 ka ngritur gjithsejtë 501 aktakuza, ndaj 573 personave, për vepra të ndryshme penale.
Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie ka ngritur 474 aktakuza kundër 533 personave. Në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë gjatë muajit mars janë ngritur 24 aktakuza kundër 34 të pandehurve.
Ndërkaq, Prokuroria Themelore në Prizren gjatë muajit mars ka ngritur 160 aktakuza kundër 204 peronave. 154 aktakuza kundër 197 personave janë ngritur nga Departamenti i Përgjithshëm, ndërkaq 6 aktakuza kundër 7 personave janë ngritur nga Departamenti i Krimeve të Rënda. E në prokurorinë Themelore të Mitrovicës gjatë muajit mars janë ngritur gjithsej 342 aktakuza kundër 383 personave.
Departamenti për Krime të Rënda i kësaj prokurorie i ka ngritur 11 aktakuza kundër 20 personave, ndërkaq Departamenti i Përgjithshëm 331 aktakuza kundër 363 personave.
Në Prokurorinë Themelore në Gjakovë gjatë muajit mars janë ngritur 104 aktakuza kundër 127 personave për vepra të ndryshme penale nga Kodi i Republikës së Kosovës.
Në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë kësaj periudhe janë ngritur 8 aktakuza kundër 17 personave. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie ka ngritur 96 aktakuza kundër 110 personave. Po ashtu, edhe Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë muajit mars ka ngritur 177 aktakuza kundër 181 personave për vepra të ndryshme penale. Departamenti për Krime të Rënda i kësaj prokurorie ka ngritur 18 aktakuza, ndaj 22 personave, ndërsa Departamenti Përgjithshëm, 159 aktakuza ndaj 159 personave.
Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur 155 aktakuza ndaj 189 personave gjatë muajit mars për raste të ndryshme penale. Në Departamentin për Krime të Rënda janë ngritur 18 aktakuza ndaj 27 personave, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj Prokurorie janë ngritur 137 aktakuza ndaj 162 personave.
Në Prokurorinë Themelore të Pejës gjatë muajit mars janë ngritur gjithsej 228 aktakuza kundër 261 personave për vepra të ndryshme penale. Departamenti i Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Pejës ka ngritur gjashtë aktakuza kundër 12 të pandehurve. Kurse në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore të Pejës janë ngritur 222 aktakuza kundër 249 personave.
Prokuroria e Shtetit mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

## Turqia i kërkon Shkupit dorëzimin e gylenistëve



SHKUP, 3 PRILL - Ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Hulusi Akar, ka kërkuar nga institucionet e Maqedonisë së Veriut, që të marrin masa kundër, siç ka thënë, "strukturave terroriste të organizatës Feto" që veprojnë në territorin e këtij vendi e që, sipas tij, po dëmtojnë "raportet mes dy vendeve, miqësinë dhe lidhjen vëllazërore". "I kemi emrat e disa prej personave kryesorë të organizatës terroriste dhe thellë jam i bindur se ditët e ardhshme institucionet e Maqedonisë së Veriut do të marrin masa konkrete lidhur me këtë. U besojmë institucioneve të Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar ministri turk i mbrojtjes, Akar, pas takimit në Shkup me ministren e Mbrojtjes të Maqedonisë, Radmilla Sheqerinska.
Ministrja Sheqerinska ka pranuar se me homologun e saj turk ka biseduar për shumë çështje, përfshirë edhe atë të ngritur nga ministri turk, por pa dhënë detaje. Ajo ka thënë se nuk beson se problemi i ngritur nga zyrtari turk do të ndikojë në ratifikimin e protokollit nga ana e Turqisë për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. "Turqia është partnere shumëvjeçare dhe shtet mik i yni. Kemi biseduar në drejtim të zgjidhjes së problemeve dhe sfidave me të cilat përballen dy vendet, përfshirë edhe këtë problem. Nuk kemi biseduar për afate, çështje ditësh apo javësh, por për çështje që janë të rëndësishme për dy vendet. Nuk kemi dilema se Republika e Turqisë do ta ratifikojë protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO", ka deklaruar Sheqerinska.

# Stoltenbergu: ShBA-ja mbetet shtylla kurrizore e NATO-s

"Amerika ka qenë shtylla kurrizore e Aleancës sonë. Ajo ka qenë thelbësore për sigurinë evropiane dhe për lirinë tonë. Ne nuk do të kishim një Evropë paqësore dhe të begatë që shohim sot pa sakrificën dhe angazhimin e Shteteve të Bashkuara", tha Stoltenbergu me rastin e 70-vjetorit të Aleancës në Kongresin Amerikan, ku u prit me duartrokitje të gjata




UASHINGTON, 3 PRILL - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, foli të mërkurën përpara një sesioni të përbashkët të Kongresit Amerikan, në prag të një takimi në Uashington të ministrave të jashtëm të aleancës. Fjalimi u mbajt me rastin e 70-vjetorit të Aleancës dhe ftesa për Stoltenbergun synon ta tregojë mbështetjen dypartiake që ekziston në Kongresin Amerikan për NATO-n.
Sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg, u prit në Kapitol me duartrokitje të gjata. Është hera e parë që një sekretar i përgjithshëm i Aleancës flet përpara dy dhomave të Kongresit Amerikan.
Stoltenbergu theksoi se NATO-ja është jo vetëm aleanca më jetëgjatë, por edhe më e suksesshmja në histori. "Që nga themelimi i NATO-s në vitin 1949, çdo Kongres, çdo president amerikan, burrat dhe gratë tuaja në uniformë dhe njerëzit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë qenë përkrahës të vendosur të NATO-s. Amerika ka qenë shtylla kurrizore e Aleancës sonë. Ajo ka qenë thelbësore për sigurinë evropiane dhe për lirinë tonë. Ne nuk do të kishim një Evropë paqësore dhe të begatë që shohim sot pa sakrificën dhe angazhimin e Shteteve të Bashkuara", tha Stoltenbergu.
Sekretari i Përgjithshëm e mbajti fjalimin pas një takimi që pati të martën në Shtëpinë e Bardhë me presidentin Donald Trump ku, mes të tjerash, u fol për ndarjen e barrës financiare mes anëtarëve të Aleancës. Ai tha se mesazhi i presidentit për një ndarje më të drejtë të barrës së shpenzimeve ka filluar të ketë ndikim real.
Ftesa për Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s erdhi nga kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi dhe udhëheqësi i shumicës së Senatit, Mitch McConnell, për ta treguar mbështetjen dypalëshe që aleanca 70-vjeçare gëzon mes ligjvënësve, pavarësisht prej kritikave që presidenti Donald Trump i ka bërë herë pas here aleancës. "Ne frenuam Bashkimin Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë. Ndaluam mizoritë në Ballkan. Luftuam terrorizmin nga Afganistani në Lindjen e Mesme. Mirëpritëm vendet e reja të lira të Evropës Qendrore dhe Lindore në Aleancë, duke ndihmuar në përhapjen e demokracisë, paqes dhe begatisë", tha Stoltenbergu.
Ai tha se dyert e NATO-s janë të hapura dhe se me mbështetjen e aleatëve, Republika e Maqedonisë së Veriut do të bëhet anëtarja e 30. Por, Stoltenbergu shtoi se suksesi në të kaluarën nuk është garanci për suksesin në të ardhmen.
Fjalimi i tij vjen në prag të takimeve të ministrave të jashtëm të NATO-s në Uashington.
Sesioni i tyre i parë sot (e enjte) do të përqendrohet te Rusia. Ministrat pritet të miratojnë një paketë masash për ta përmirësuar mbrojtjen e NATO-s në Detin e Zi. Tema të tjera do të jenë misioni i NATO-s në Afganistan dhe vendimi i shpallur nga Turqia për të blerë një sistem raketash ruse.

# Protesta masive, jep dorëheqje presidenti i Algjerisë



ALGJER, 3 PRILL - Presidenti i Algjerisë, Abdelaziz Bouteflika, dha dorëheqje të martën pas 20 vjetësh në detyrë dhe gjashtë javë protestash masive mbarëkombëtare, që synonin ta rrëzonin atë dhe rrethin e tij të ngushtë shumë të kritikuar nga pushteti, për të krijuar një demokraci të vërtetë në kombin e pasur me gaz.
Njoftimi pasoi një thirrje të rreptë nga shefi i fuqishëm i ushtrisë drejtuar presidentit Bouteflika, 82 vjeç dhe i sëmurë, që ta pranojë "menjëherë" propozimin e tij për t'u larguar duke respektuar kushtetutën.
Nuk është bërë e qartë se kush do ta zërë vendin e tij por, sipas kushtetutës, kryetari i Dhomës së Lartë të parlamentit merr përsipër udhëheqjen më së shumti për 90 ditë dhe ndërkohë duhet të mbahen zgjedhjet.
Agjencia zyrtare e lajmeve APS tha se presidenti Bouteflika e ka njoftuar Këshillin Kushtetues për vendimin e tij që t'i japë fund mandatit.
Shefi i Armatës, gjenerali Ahmed Gaid Salah, më herët gjatë ditës mblodhi hierarkinë më të lartë ushtarake, duke i bërë të qartë presidentit Bouteflika se nuk e ka më mbështetjen e ushtrisë, një nga më të rëndësishmet në kontinentin afrikan. Presidenti Bouteflika është parë shumë rrallë në publik që nga viti 2013 kur ishte sëmurë.

## Gjykata e Hagës i refuzon apelin Karaxhiqit



HAGË, 3 PRILL - Gjykata për Krime e Kombeve të Bashkuara në Hagë ka refuzuar apelin e fundit të ish-liderit të serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, duke thënë se vendimi i këtij trupi ka qenë përfundimtar.
Gjyqtarët e Tribunalit kanë thënë më 3 prill se "Karaxhiqi nuk ka asnjë bazë ligjore për ta apeluar vendimin", i cili e ka ndëshkuar atë me burgim të përjetshëm për masakrën në Srebrenicë dhe mizoritë e tjera gjatë luftës në Bosnjë.
Në Srebrenicë janë vrarë më shumë se 8,000 burra dhe djem myslimanë nga forcat serbe të Bonjës, për ta shënuar mizorinë më të keqe në Evropë prej Luftës së Dytë Botërore. Më 20 mars, gjykata i ka rritur Karaxhiqit dënimin, pasi fillimisht ishte dënuar me 40 vjet burgim. Më shumë se 100 000 persona janë vrarë dhe rreth 2.2 milionë të tjerë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre gjatë Luftës në Bosnjë në periudhën 1992-1995.

# Nga modele në këngëtare

Bernadeta Nikollbibaj, e cila karrierën artistike e ka nisur me modelizëm në Zvicër, ka vendosur ta sprovojë veten edhe në këngë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ajo ka treguar për planet që ka për t'i arritur majat e estradës



"Epoka e re"

**Prishtinë, 3 prill** - Veprimtarinë e saj artistike e ka nisur me modelizëm, duke qenë një nga protagonistet kryesore në agjencitë e modelizmit në Zvicër. Bernadeta Nikollbibaj ka vendosur të largohet nga kjo fushë për ta nisur karrierën muzikore. Nikollbibaj, me emrin artistik "Ana", e cila sapo ka lansuar projektin muzikor së bashku me reperin Abin, "Je t'aime" (Të dua), i cili është shndërruar në njërin nga këngët më të pëlqyera. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ana ka zbuluar planet e saj për karrierën dhe muzikën.




**"Epoka e re":** *Për publikun shqiptar jeni njohur si modele. Si ju lindi ideja të bëni edhe muzikë?*
**Nikollbibaj:** Karrierën e kam filluar si modele në fillim në agjenci të modës këtu në Zvicër, ku edhe jetoj, për të vazhdar në spektakle të modës në trevat shqiptare, ku kam marrë çmimin 'Miss Grande Kosova' në njërin kompeticion të organizuar në Kosovë. Pasionin për muzikë e kam pasur më herët, por tash erdhi koha që të merrem më intensivisht me muzikë.

**"Epoka e re":** *Kënga juaj e parë "Je t'aime" (Të dua) është duke u pëlqyer mjaft nga publiku. Si erdhi deri te ky bashkëpunim?*
**Nikollbibaj:** Unë kam marrë një ofertë bashkëpunimi me reperin Abi, me të cilin është realizuar ky duet. Këtë bashkëpunim e kam pranuar me kënaqësi. Jam shumë e kënaqur me këtë projekt pasi është mirëpritur shumë mirë nga publiku, sidomos refreni është një gjë të cilin e kam shumë për zemër.

**"Epoka e re":** *Cilat janë planet e juaja për muzikën?*
**Nikollbibaj:** Pas këngës "Je t'aime" unë kam angazhuar menjëherë edhe bashkëpunëtorët e mi për të punuar edhe në dy projekte të tjera muzikore, ku shumë shpejt njërin do ta sjell me videoklip. Besoj shumë në të pasi është një ritëm i cili do t'i përgjigjet mjaft mirë tregut muzikor.

**"Epoka e re":** *Kush janë bashkëpunëtorët tuaj për projektin e radhës?*
**Nikollbibaj:** Në bazë të konsultimeve të menaxhmentit tim, për projektim tim të dytë kemi vendosur të sjellim një këngë solo, ritmike të zhanrit RNB. Kënga është punuar në studion e Hekuran Krasniqit, teksti dhe muzika nga Alban Miroci, të cilën së shpejti do ta sjellim me videoklip.

# Prishtina afër nënshkrimit të marrëveshjes për organizimin e 'Manifesta 2022'

**Prishtinë, 3 prill (ER)**- Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se Prishtina është në hapin përfundimtar para nënshkrimit të marrëveshjes për organizimin e Bienales Evropiane të Artit Bashkëkohor në vitin 2022, e njohur si "Manifesta". "Megjithëse Prishtina ka konkurrencë Vjenën dhe Kievin, gjasat janë të mëdha që të fitojmë e që ky organizim të realizohet në Prishtinë. Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë e mbështet Bienalen 'Manifesta'. Ideimi dhe puna për ta realizuar këtë Bienale në Prishtinë ka nisur dhe është çuar përpara në kohën kur Lëvizja Vetëvendosje udhëhiqte Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prishtinës, përmes drejtorit Yll Rugova. Organizimi i Bienales 'Manifesta' në Prishtinë do ta mundësonte ardhjen e mbi 200 000 vizitorëve ndërkombëtarë në Prishtinë si dhe prurjen e dhjetëra miliona euro në ekonominë e Kosovës në format nga më të ndryshme", është bërë me dije në komunikatën e LV-së.
Në këtë komunikatë theksohet se duke qenë nikoqire e Bienales 'Manifesta', Prishtina do të kthehej në një kryeqendër evropiane të kulturës, ku emrat më të njohur të artit dhe arkitekturës do të realizonin projekte enkas për qytetin, kurse urbanistë të njohur si Renzo Piano, Rem Koolhaas, Winy Maas etj., do të bënin projekte për zhvillimin e Prishtinës. "Emra me ndikim në artin botëror gjithashtu do të gravitonin në kryeqytetin tonë për këtë ngjarje. Prishtina do të përfitonte edhe investime në infrastrukturë, duke rehabilituar hapësira kulturore, e duke ndërtuar hapësira të reja publike", ka njoftuar Vetëvendosje.




Sipas kësaj lëvizje, në këtë fazë ka mbetur të sigurohet vetëm garancia bankare nga Qeveria e Kosovës dhe nënshkrimi i marrëveshjes me Komunën e Prishtinës, në mënyrë që Prishtina të shpallet zyrtarisht nikoqire e Bienales Evropiane "Manifesta" në vitin 2022. "Andaj, kërkojmë dhe i bëjmë apel pushtetit qendror dhe lokal që t'i ndërmarrin sa më parë të gjithë hapat e nevojshëm që mundësojnë finalizimin e marrëveshjes, përfshirë këtu edhe garancinë bankare për këtë organizim dhe lehtësimin e të gjitha procedurave. Ky projekt i takon qytetit të Prishtinës dhe gjithë Kosovës. Duhet bërë çmos që çdo pengesë të eliminohet dhe çdo bllokadë të rrëzohet, që ta kemi në Prishtinë Bienalen Evropiane 'Manifesta'", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

E jashtëzakonshme

# Pishina më e thellë në botë pritet të hapet në Poloni



Për të apasionuarit pas zhytjes ka një risi. Në Poloni është drejt përfundimit pishina më e thellë e botës, që mbërrin deri në 45 metra. Pishina premton të jetë vendi ideal për zhytësit profesionistë, por edhe për amatorët. Ajo do të mbajë 8 000 metra kub ujë, një vëllim 27 herë më i madh sesa ai i një pishine të zakonshme 25 metra.

FOTO E DITES



Dielli në urën e këmbësorëve të "Eiserne Steg" (Iron Footbridge) në Frankfurt të Gjermanisë. /AP/

E rrallë

# Minjtë i hëngrën këmbët, qeni pajiset me proteza të reja



Piedino është një qen rrugë, por kur ishte këlysh u sulmua nga minjtë, të cilët i hëngrën këmbët. Ai ishte i destinuar t'i nënshtrohej eutanazinës, ose në rastin më të mirë t'i amputoheshin të gjitha gjymtyrëve. Maria Giammona, një vullnetare siciliane që shpëtoi qenin duke përfshirë mjekët nga "Catania Vet" dhe "Orto Vet", arriti ta bëjë të pamundurën. Piedonos iu vendosën protezat në të katër këmbët. Tani qeni mund të shpresojë për një jetë më të mirë.

## BARSOLETA E DITËS



- Zemër, më thuaj sa më do prej 1 deri në 10.
- Deri në 10 të dua, zemër, a prej 11-ve do të dal me shokë të pi birra.

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

**"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D**

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois





**Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)**

**"THE KID WHO WOULD BE KING",**

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish

**Në ora 20:00**

**"CAPTAIN MARVEL" 3D**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

**Rolet:** Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

**Regjia:** Anna Boden, Ryan Fleck





**Në ora 22:00**

**"U S"**

Horror/Triller; 1 ore 56 min

**Rolet:** Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
**Regjia:**Academy Award®-winning visionary Jordan Peele

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Mos kini drojë të ballafaqoni disa persona sot. Kanë folur për çështje që nuk ju takojnë aspak dhe është mirë ballafaqimi.



**DEMI** Duhet të tregoheni të kujdesshëm dhe të mos bini pre e provokimeve sot. Dikush po tenton t'ju nxjerrë keq në një situatë të caktuar.



**BINJAKËT** Nëse do të tregoheni të vrazhdë sot nuk do të arrini asgjë. Mendoni që autoriteti vendoset me frikë, por keni zgjedhur rrugën e gabuar.



**GAFORRJA** Filloni ditën me buzëqeshje sot, dëgjoni muzikë të mirë dhe takoni në një drekë miqtë tuaj. Kënaqësitë e vogla i japin kuptim jetës.



**LUANI** Sot do t'ju duhet t'i lini vetëm personat tuaj të dashur për t'u marrë me një punë shumë të rëndësishme. Do ta ndjeni mungesën e tyre përgjatë gjithë ditës.



**VIRGJERESHA** Jeni shumë të ndjeshëm sot dhe në çdo moment jeni të gatshëm të ankoheni. Të gjitha gjërat duket sikur nuk shkojnë mirë dhe jeni nën presion.



**PESHORJA** Nuk jeni person që shkoni pas thashethemeve megjithëse dëgjoni shumë. Pozita në të cilën ndodheni aktualisht ju bën shënjestër të personave të tjerë.



**AKREPI** Nëse doni të reflektoni mbi ofertat profesionale që ju janë bërë së fundmi sot është dita e duhur. Do të bëni një zgjedhje disi të rrezikshme.



**SHIGJETARI** Shumë mendime të dhëna në tym ju kanë bërë me konfuze seç ishit. Doni të qetësoheni dhe do të shkoni në një vend që për ju është ideali.



**BRICJAPI** Sot jo shumë persona do të arrijnë të kuptojnë atë që doni të thoni. Për këtë shkak do të ketë debate të forta midis jush dhe një të linduri të shenjës së Peshqve.



**UJORI** Nëse nuk doni të krijoni debat me personin e zemrës mos hapni sot një temë bisede që do t`ju shqetësonte të dyve.



**PESHQIT** Sot do të keni probleme me personat që kanë kërkuar mbështetjen tuaj për një projekt të caktuar. Nuk i keni mbështetur kur nevojitej.

# Ava Max kryeson top listat britanike



Që nga fillimi i vitit 2019 ka sjellë shumë hite botërore. E në Britani të Madhe një shqiptare po kryeson toplistat kryesore. Këngëtarja, e njohur me emrin artistik Ava Max, po dominon top listat me këngën 'Sweet but Psycho'. Projekti i shqiptares është kënga më e transmetuar e vitit në Britani të Madhe. Ava Max ka lënë pas emra të njohur si Ariana Grande, Calvin Harris Rag'n Bone' dhe Dua Lipa.

# Arrestohet i dyshuari për vrasjen e reperit Nipsey Hussle



Është arrestuar një i dyshuar për vrasjen e reperit të Los Angeles Nipsey Hussle, kanë bërë me dije zyrtarët policorë. 29-vjeçari Eric Holder ishte në arrati, pasi u largua nga skena e krimit me një makinë që ishte në pritje, ka njoftuar Departamenti i Policisë në Los Anxhelos. Hussle, 33 vjeç, u qëllua jashtë dyqanit të tij të veshjeve në Los Anxhelos të dielën. Hetuesit besojnë se vrasja vjen si rezultat i një "çështje personale" ndërmjet Holder dhe Hussle. Kamerat e sigurisë tregojnë një burrë me një këmishë të errët që qëllon të paktën tri herë përpara se të largohet, ka raportuar "TMZ".



# Kylie dhe Travis dëshmojnë se nuk janë ndarë

Kylie Jenneri dhe Travis Scott ishin në ballinat e mediave rozë për disa ditë rresht, pasi u tha se reperi e tradhtoi atë. Mirëpo, çifti e ka mohuar këtë gjë më në fund, duke postuar një video në "Instagram". Kylie publikoi një video të reperit me vajzën e tyre Stormi. Kjo është hera e parë që ai është shfaqur në profilin e saj pas shumë spekulimeve. Në video Travis shihet duke ndihmuar vajzën të ecë shkallëve.

# Kim Kardashiani tregon emrin e fëmijës së katërt



Kim Kardashian dhe Kanye West po presin fëmijën e tyre të katërt së bashku, një djalë. Ajo u shfaq tek Jimmy Kimmel Live, ku foli për një nga emrat e mundshëm për foshnjën. "Kam menduar për një emër si Rob, si vëllai im. Por tani është North, Saint, Chicago, Rog dhe nuk po shkojnë. Por ky është emri i vetëm me të cilin ndihem mirë", ka thënë Kimi.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | MYNXYRË; HALL I MADH | KUNDREJ PROLOG | SËMUNDJE E RËNDË QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.) | | NË TË VËRTETË; MADJE / ARIANIT (perkdh.) | EPOKA E RE | VENDI KU PULA PJELL VEZËT, FURRIK (krah.) | AKTORI HOLLIVUDIAN SANDLER | INAT QË NA HIPËN KUNDËR DIKUJT A DIÇKAJE | HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND" | NORA ISTREFI |
| | | | | | | SYSHTREM-BËR | | | | | | ENË E MADHE TENEQEJE PËR TË ZIER UJË | | | | | |
| | | | | | | GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE | | | | | | ISH BASKE-TBOLLISTI YNË HABIB | | | | | |
| | | | | | | MJET PREJ TUNXHI, SI KAMBANË FARE E VOGËL (sh.shq.) | | | | | | ËMË / NJËSI PËR MATJEN E KAPACITETIT ELEKTRIK | | | | | GDHENDA |
| | | | | | | HOV, VRULL | | | | | ZULMË / KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE | | | | | BASHKËT. / SHTET FEDERAL NË SHBA (shqip.) | |
| | | | | | | HALLKË E HEKURT QË I VIHET BOSHTIT TË RROTAVE TË QERRES | | | | MICHIGAN ASSOCIATION REALTORS / DESPOTIK | | | | ZHANËR I MUZIKËS | | | |
| | | | | | | EPOKA E RE | KITARË (bised.) / SHËRIM | | | | | | | I KAPËRDIJ / PASANIKJA | | | |
| | | | | | | SHKRONJA XV | | KËNGËTARJA BARAKU / BIXHOZ | | | | | SMALT / QËNDRUESH-MËRIA NDAJ SFIDAVE (arab.) | | | | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARJA NË FOTO | NDJENJA QË KEMI KUR JEMI PA NGRËNË | LLOJ HELMI LUFTE | NEON | EPOKA E RE | UNITED KINGDOM / BASHKËT. | | | TENISTI I SHQUAR ENDI ..... / BASHKËT. | | | | | | JEMENI, INDONEZIA / KALORËS MESJETAR | | |
| DEL PËR GJAH | | | | | ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY / HATA | | | | | | | LLOJ LETRASH FATI / KORIJA | | | | | |
| MODEL, MOSTËR (turq.) | | | | | | INVA MULA / KORNIZË | | | SHKRIMTARI TURK ..... HIKMET (shq.) / SPORTIST QË MERRET ME NOT | | | | | | | ZANORE / ESTONIA, LITUANIA | |
| SILIC, TON | | | | RAFTI / VËLLAI I MADH | | | | | | | QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË (F.) | | | | | | AKTORJA ISMAILI |
| MURI ME DËRRASA | | | | | | | LLOJ GRURI I SHKURTËR, ME KALLI PA HALA / LLOJ SHPENDI | | | | LLOJ SHTRATI ME DY DR-URË ANASH / PJESËTAR I NJË POPULLI NË SI LANKË | | | | | | |
| ZANORE | | ANTON PASHKU / INSTRUMENT MUZIKOR | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / NJOLLA | | | BASHKËT. / SHKRONJA XIX | | GRADË NË USHTRI / PJESËTARI I NJË FISI ILIR | | | | | | BASHKËT. / VËLLAI I BURRIT | |
| QË ËSHTË KRIJUAR PËR T'U KËNDUAR; ZANOR | | | | | | ARKEOLOGU SKËNDER / RITUALE | | | | | | | | GJELBËRIM | KLINT ISTVUD / BAKËR | | |
| | | | | TË BUKURIT / KËNGËTARE E FAMSHME AMERIKANE | | | | JEVGU / LLOJ METALI | | | | | LEGJENDA E "KUNG FU-së" .... LEE (shqip.) / EUROPEAN MUSIC OFICE | | | | |
| SHKËLQIM I VENDIT KU JETOJMË / NOTË MUZIKORE | | | BASKETBO-LLISTI MALIQI / VEGËL MUZIKORE | | | | | | VARIOLË / RRAHJE ME SHKOP (shq.) | | | SHKRIMTARJA KADARE | | | | | |
| FEMRAT E ARIUT | | | | | | | IDHULL / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | KËNGËTARJA VALBONA / GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ | | | | | TËRËSIA E ANIJEVE LUFTARAKE |
| | | | | | NERGUT / NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË (shq.) | | | | | | VRIMË SHUMË E VOGLA NË DIÇKA / SEKRETARI I OKB-së BAN KI | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / ISH BASKET-BOLLISTI YNË ALEKSANDER | | |
| E VADITA, E ...... | NËNNDARJA E NJË LIGJI / KOD I TELEFONIT CELULAR | | | | | KUNDREJT NDALIMI / TAKOJ DIKË A DIÇKA RASTËSISHT | | | | | | | JETË PA TRAZIME (libr.) / FUTBOLLISTI SAMUEL ... | | | | |
| PAMELA ANDERSON | | | TURN KLUB HANNOVER / NAIM ABAZI | | | | NOTË MUZIKORE / NAIM ISMAJLI | | | KLERIK I SHKOLLUAR MYSLIMAN / DUKAT | | | | | | ZANORE / ISMET JASHARI | |
| ZANORE | | LLOJ VETURE JAPONEZE / SHKRONJA X-të | | | | | | SECILA NGA FLETËT QË MBYLLIN DRITAREN TROYES | | | | | | GOJËDHËNË / BASHKËT. | | | |
| PREJ KU | | | | I VËNË NË SITË | | | | | | | FOTOGRAFIA (bised.) | | | | | | |

# Google+ mbyllet: Çfarë duhet të dini dhe çfarë të bëni nëse ende keni një llogari



Lamtumirë Google+ 2, prilli do të jetë dita përfundimtare e mbylljes së Google +. Rrjeti social Big G nuk ishte në gjendje të kapte përdoruesit dhe kështu, pas vetëm tetë viteve të jetës, kompania vendosi ta braktiste atë përgjithmonë. Përmbledhje e të metave të sigurisë që ka prekur 500 mijë përdorues. Por, duke pasur parasysh se disa platforma që tani i përkasin të kaluarës – në radhë të parë MySpace – janë akoma aktive, edhe pse tani kanë hyrë në varreza të heshtura, është e çuditshme të mendojmë se nuk do të shohim "G-plus" mes rrjeteve kryesore sociale në një sfond të kuq. Kompania e arsyetoi vendimin "për shkak të përdorimit të ulët dhe sfidave për të mbajtur një produkt të suksesshëm që plotëson pritjet e përdoruesve".

E vërteta është ndoshta se kjo e metë ishte me të vërtetë invazive dhe se ka ardhur koha për t'i thënë lamtumirë Google+. Këtu është një udhëzues i shpejtë dhe i lehtë për t'u përgatitur për mbylljen e shërbimit, por së pari nevojitet një sqarim. Vetëm shërbimi Google + do të mbyllet dhe jo Gmail, Google Photos ose ndonjë platformë tjetër të gjigantit Mountain Vieë. Profili i Google gjithashtu do të mbetet i pandryshuar. Shkelja e sigurisë Google+ ka lindur në qershor 2011 në një përpjekje për të konkurruar me Facebook dhe Tëitter, rrjetet sociale që në atë kohë po përjetonin një periudhë të suksesit të madh. Shërbimi u hartua për të dialoguar në mënyrë aktive me produktet e tjera të ekosistemit Google, si p.sh. YouTube.

Dhe në të vërtetë në vitet e para numri i abonentëve u rrit shpejt – çdokush me një llogari gmail ose në platformën video më në fund e provoi – por në aspektin e përdorimit, mediat sociale kurrë nuk ishin në dorë të rivalëve. Koha mesatare e shpenzuar në Google+ ishte rreth 5 sekonda. Dhe pavarësisht se ka arritur pragun e rreth 300 milionë përdoruesve, në nivelin ekonomik (dhe jo vetëm) projekti ishte në fakt një dështim.

Në tetor, Wall Street Journal raportoi një shkelje në sigurinë e Google + (që ndodhi në një periudhë prej 2015 deri në mars 2018), gjë që do të vinte në rrezik të dhënat private të llogarive të 500 mijë përdoruesve. Kompania pastaj konfirmoi, së pari duke njoftuar një seri ndryshimesh të privatësisë dhe pastaj bllokimin përfundimtar të shërbimit.

Sipas hetimit, emrat dhe mbiemrat e qindra njerëzve dhe adresat e tyre të postës elektronike, data e lindjes, gjinia, vendbanimi, profesioni dhe statusi martesor mund të kenë qenë "të ekspozuara", edhe pse kompania "nuk ka prova për përdorime të pahijshme". Përse mbyllet Një ish-punonjës i projektit, Morgan Knutson, menjëherë pas shpalljes së mbylljes përfundimtare të rrjetit social, vendosi të tregonte "sa të tmerrshëm ishin kolegët dhe menaxherët". Sigurisht, fjalët e një ish-i duhet gjithmonë të merren me një distancë minimale, por zbulimet e njeriut janë tronditëse. Është e rrallë për të lexuar fjalë të zjarrtë në Google nga ish-punonjësit (Knutson ka punuar atje për tetë muaj deri në vitin 2012): gjiganti hulumtues online mbetet një nga kompanitë më të mira të Silicon Valley për të punuar dhe është e vështirë që ankesat të dalin.

Por Knutson kishte arritur limitin. Para së gjithash, njeriu përshkruan një shërbim që mungon tërësisht nga një vizion i përgjithshëm, një projekt që po harxhonte burime dhe që megjithatë shkoi përpara falë mbrojtjes së Vic Gundotra, një ish-menaxhues i fuqishëm i Google, i cili kishte marrë drejtimin e shoqërisë. "Nuk kam imagjinuar kurrë të bashkohem me një ekip prej më shumë se 50 dizajnuesish, shumë prej të cilëve kurrë nuk kishin projektuar diçka më parë", shkruan zbuluesi, "Ata nuk ishin praktikantë, ata ishin dizajnerë në debutimin e tyre absolut dhe ata e bënë atë në Google", vazhdon i zhgënjyer, "Mendimi i parë ishte 'çfarë?!?'

"A do të ishte kjo një punë? Dhe ju paguajnë për ta bërë atë?" Knutson e ka atë për të gjithë, madje edhe me ndërtesën ku punoi ("Mund të përshkruhet vetëm si kitsch, mobilie e shëmtuar, e shpifur") dhe madje edhe me veganin e kafesë Larry Page, një nga dy themeluesit, "një vend në modë të quajtur Cloud se nuk do të ishte e qëndrueshme në botën reale". Por është për kolegët që rezervojnë helmin më të madh. Mos harroni një zëvendëspresident, Vic Gundotra, i cili e përdori karizmin e tij për të "flirtuar vazhdimisht me gratë e ekipit", i cili "mund të shihte ekranin e kompjuterit tim nga pozicioni i tij" dhe "në tetë muaj në të cilin përfundova duke udhëhequr ridizajnimin ai nuk ka thënë një fjalë në lidhje me produktin e tij, pa përshëndetje, pa mirupafshim, pa falënderime, pa shtrëngim duarsh apo kontakt me sy".

Çfarë humbim dhe si ta shpëtojmë Më 2 prill, serverët do të fshijnë gjithçka që është e pranishme në Google+ që do të thotë profilin tonë dhe fotot dhe videot që kemi ruajtur në albume. Por mos u frikësoni. Duke pasur parasysh përdorimin e vogël që shumë prej nesh kanë bërë, ndoshta nuk do të ketë asgjë të postuar. Për të qenë i sigurt, megjithatë, mjafton të hapësh sajtin Google+ nga kompjuteri yt. Në këtë pikë mund të zgjedhim të ruajmë atë që na intereson dhe nëse dëshirojmë të lëvizim skedarët në Fotot e Google, iCloud, Flickr ose ndonjë platformë tjetër fotografike. Si të shkarkojmë të gjitha të dhënat tona Për ata që kanë bërë përdorimin intensiv të mediave sociale, Google ju lejon të shkarkoni një paketë me të gjitha të dhënat.

Mjafton të zgjidhni të gjitha të dhënat që jeni të interesuar për shkarkimin dhe më pas zgjidhni formatin me të cilin do të shkarkohen (.zip është mirë), madhësinë (vendosim 50 Gb për të qenë i sigurt) dhe si t'i pranojmë ato. Në rastin e fundit ne do të jemi në gjendje të zgjedhim, nëse i kemi ato, t'i ngarkojmë të dhënat drejtpërdrejt në një shërbim tjetër cloud si Dropbox, Box, Drive ose OneDrive. Për shumë prej nesh (shumica, në pasqyrim) mbyllja nuk do të sjellë ndonjë ndryshim. Ne thjesht nuk mund të postojmë përmbajtje në mediat sociale, por duke parë që shumë pak njerëz e bënin atë kur ishte në kapacitet të plotë, vështirë të ndjehet mungesa tani.










# Llapi tregon forcën ndaj Ferizajt, rikthehet në vendin e dytë

Llapi, Drita dhe Trepça '89 kanë shënuar fitore si vendës ndaj Ferizajt, KEK-ut dhe Flamurtarit. Drenica dhe Gjilani kanë luajtur baras, kurse dy ndeshjet e fundit të kësaj xhiroje zhvillohen sot dhe takohen Feronikeli - Ballkani dhe Prishtina - Liria

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 PRILL - Skuadra e Llapit është treguar shumë e fortë për Ferizajn, pasi e ka mposhtur me rezultat 2-0. Djelmoshat e drejtuar nga Tahir Batatina e kanë nisur mirë ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" dhe arritën të shënojnë pas tre minutash lojë nëpërmjet sulmuesit Ahmed Januzi. Skuadra mysafire në pjesën e parë pati tri raste, por Demiri, Gashi dhe Dautaj nuk arritën ta barazojnë rezultatin, kurse në përfundim të kësaj pjese për vendësit golin e dytë e shënoi Festim Alidema. Në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati dhe ndeshja përfundoi 2-0. Pas kësaj fitoreje Llapi është rikthyer në pozitën e dytë në renditjen tabelore, kurse Ferizaj mbetet në të dhjetën me 25 pikë. Fitore bindëse shënoi kampionia në fuqi, Drita, me rezultat 4-0 ndaj KEK-ut. Një autogol, dy gola nga Kyrian Nwabueze dhe një nga Përparim Osmani e kompletuan fitoren e gjilanasve para derbit të Anamoravës, Gjilani - Drita. Trepça '89 ishte skuadra e tretë vendëse që të mërkurën i është gëzuar fitores, pasi e fitoi përballjen ndaj Flamurtarit. Të vetmin gol në këtë ndeshje e realizoi Hasan Hyseni.




## Feronikeli dhe Prishtina paralajmërojnë fitore

Dy ndeshjet e fundit për javën e 25-të zhvillohen sot (e enjte), kurse takohen Feronikeli - Ballkani dhe Prishtina - Liria. Sulmuesi Kastriot Rexha ka paralajmëruar se "Nikli", pas barazimit në fundjavë ndaj Flamurtarit, sot do të shënojë fitore ndaj skuadrës së Ballkanit. "Ndeshjen e radhës e kemi ndaj Ballkanit në shtëpi dhe normalisht se presim fitore. Përndryshe, skuadra e Ballkanit është mjaft cilësore dhe ka futbollistë të dëshmuar. Ne e respektojmë maksimalisht, por pikët mbesin në Drenas", ka thënë Rexha për "Epokën e re".
Gazeta ka kontaktuar edhe futbollistët e Ballkanit, por ata kanë thënë se klubi ua ka ndaluar prononcimin për medie para ndeshjes me Feronikelin.
Për fitore është përgatitur maksimalisht edhe Prishtina që e pret Lirinë në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet. Sulmuesi i "bardhekaltërve", Marjo Morina, ka thënë se ndeshja ndaj Lirisë ka rëndësi të madhe dhe për fitore duhet të angazhohen maksimalisht sikur kundërshtar të ishte Feronikeli. "Në ndeshjet e fundit kemi marrë maksimumin e pikëve. Besoj se jemi futur në ritëm dhe nuk do ndalemi më. Ndërsa Lirinë duhet vlerësuar maksimalisht, sepse s'mund të thuash që është ekip i dobët veçse pësoi katër gola me Llapin në fushën e vet. Ne duhet t'ia bëjmë hyzmetin ndeshjes si kundër Lirisë, si kundër Feronikelit që t'i marrim tri pikët, sepse nuk na falën më gabimet", ka thënë Morina për faqen e klubit kryeqytetas. Feronikeli është në pozitën e parë dhe në 24 ndeshjet e zhvilluara deri tash ka arritur 17 fitore, 5 barazime dhe 2 humbje dhe ka grumbulluar 56 pikë, kurse Prishtina është në pozitën e tretë me tri pikë me pak, kurse në pozitën e dytë është Llapi me 54 pikë.

### IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Trepça '89 - Flamurtari | 1-0 |
| Llapi - Ferizaj | 2-0 |
| Drenica - Gjilani | 0-0 |
| Drita - KEK-u | 4-0 |

Të enjten takohen:
Feronikeli - Ballkani
Prishtina - Liria

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 24 | 56 |
| 2. Llapi | 25 | 54 |
| 3. Prishtina | 24 | 53 |
| 4. Drita | 25 | 44 |
| 5. Drenica | 25 | 34 |
| 6. Gjilani | 25 | 34 |
| 7. Trepça '89 | 25 | 32 |
| 8. Ballkani | 24 | 29 |
| 9. Flamurtari | 25 | 29 |
| 10. Ferizaj | 25 | 25 |
| 11. Liria | 24 | 24 |
| 12. KEK-u | 25 | 1 |

### LIGA E PARË

| | |
|---|---|
| Fushë Kosova-Vëllaznimi | 0-0 |
| Onix-Arbëria | 0-2 |
| Ramiz Sadiku-Kika | 2-1 |
| Dukagjini-Vllaznia | 3-1 |
| Drenasi-Vitia | 2-0 |
| 2 Korriku-Trepça | 0-0 |
| Vushtrria-Besa | 2-2 |
| Bashkimi (K)-Istogu | 1-0 |

TABELA

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Vushtrria | 22 | 51 |
| 2. Besa | 22 | 48 |
| 3. Dukagjini | 22 | 44 |
| 4. Vëllaznimi | 22 | 40 |
| 5. Vitia | 22 | 37 |
| 6. Onix | 22 | 31 |
| 7. Arbëria | 22 | 29 |
| 8. Trepça | 22 | 28 |
| 9. Istogu | 22 | 26 |
| 10. Drenasi | 22 | 25 |
| 11. 2 Korriku | 22 | 25 |
| 12. Fushë Kosova | 22 | 24 |
| 13. Ramiz Sadiku | 22 | 24 |
| 14. Vllaznia | 22 | 21 |
| 15. Kika | 22 | 20 |
| 16. Bashkimi (K) | 22 | 19 |

# Gashi dhe Hasani, ATK-së: Zbatojeni Ligjin për Sponsorim

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri për Kulturë, Rini e Sport, Kujtim Gashi, i shoqëruar nga këshilltari për Sport, Daut Thaqi, ka vizituar të mërkurën Komitetin Olimpik të Kosovës, me ç'rast është nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të MKRS-së dhe KOK-ut për vitin 2019.
Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, ka vlerësuar lart mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Sportit për Komitetin Olimpik, si dhe për federatat dhe sportistët përmes nënshkrimit të memorandumeve. "Nënshkrimi i memorandumit në mes të MKRS-së dhe KOK-ut ka rëndësi të jashtëzakonshme për ne sepse plani strategjik dhe realizimi i objektivave strategjike duan edhe mbështetje financiare. I premtoj ministrit dhe Lëvizjes Olimpike se KOK-u do të angazhohet maksimalisht për arritjen e të gjitha objektivave të saj strategjike. Ne kemi mbështetje edhe nga komuniteti i biznesit, andaj plani ynë është të dominojë në të ardhmen mbështetja e biznesit me përqindje edhe më të lartë", ka thënë Hasani.
Ministri Gashi, duke shprehur kënaqësinë e të qenit në zyrat e KOK-ut, rikonfirmoi mbështetjen e madhe që ka për Lëvizjen Olimpike dhe gjithë federatat e tjera. "Jam këtu më shumë për të dhënë një mesazh mbështetje dhe përkushtimi si qeveri dhe organizatat e tjera sportive, që janë pjesë e KOK-ut, pasi është ombrella e sportit në Kosovë dhe jemi të lumtur që kemi një lidership shumë të përgatitur dhe që ka bërë një punë të jashtëzakonshme vitin e kaluar dhe me siguri të lartë e them se viti 2018 ishte më i suksesshmi, ku sportistët vendit tonë i sollën rreth 100 medalje. MKRS-ja ka rritur mbështetjen për organizatat sportive prej 1.4 milionë eurosh sa ka qenë në vitin 2017 në 3.2 milionë euro për vitin 2019", ka thënë ministri Gashi.




Presidenti Hasani dhe ministri Gashi i bënë thirrje së bashku Administratës Tatimore të Kosovës që ta zbatojë Ligjin për Sponsorime si dhe gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që Ligjin për të Ardhurat në Korporata ta harmonizojnë me Ligjin për Sponsorime në mënyrë që t'u krijojnë hapësirë më të madhe investimeve të biznesit në sport. Të dyja palët u pajtuan që të harmonizohet Ligji për Sport, bazuar në zhvillimet që po ndodhin në Lëvizjen Olimpike Botërore dhe sportin në përgjithësi. Ministri zbuloi edhe lajmin e mirë për çështjen shumë të përfolur të ndërtimit të Qendrës Nacionale të Xhudos, duke theksuar se bashkërisht me Federatën e Xhudos së Kosovës janë duke shikuar mundësinë e një tjetër alternative të gjetjes së lokacionit për ndërtimin e kësaj qendre pasi, sipas tij, pritjeve të shumta të organeve komunale të Pejës u ka ardhur fundi. Me këtë rast ministri Gashi i dha një lajm të mirë edhe Komitetit Olimpik të Kosovës, për të cilët theksoi vendimin e MKRS-së që KOK-u ta shfrytëzojë edhe një kat të objektit të Shtëpisë së Sportit, në mënyrë që të ketë hapësira më të mëdha të punës. Sipas tij, Departamenti i Sportit në MKRS do të zhvendoset në një objekt tjetër.

## Pacolli: George Weah është mrekulluar nga rezultatet e Përfaqësueses së Kosovës

Prishtinë, 3 prill - Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, e ka takuar presidentin e Liberisë, George Weah, i cili ka qenë një nga lojtarët më të mirë në historinë e skuadrës së Milanit.
Ministri Pacolli nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se me sukseset e arritura nga Përfaqësuesja e Kosovës është mrekulluar edhe një kampion si George Weah. "Në Dakar të Senegalit, ku po marr pjesë në inaugurimin e presidentit, takova edhe presidentin e Liberisë, George Weah. Presidenti Weah, i cili është mik i vjetër imi, edhe një herë rikonfirmoi mbështetjen e parezervë të vendit të tij për republikën tonë. Presidentin Weah, dikur fitues i topit të artë në futboll, e informova për ecurinë e djelmoshave tanë të kombëtares së futbollit, duke i përmendur edhe rekordin e vendosur pa humbje. Kënaqësi dhe krenari e madhe që me këto rezultate të mrekullohet edhe një kampion si Weah", ka shkruar Pacolli në "Facebook".



# Ambasadori i Norvegjisë: Jo rastësisht Kosova është storie e suksesit në UEFA dhe FIFA

**Prishtinë, 3 prill** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka njoftuar ambasadorin norvegjez në Kosovë, Per Strand Sjaastad, me zhvillimin e futbollit në Kosovë, duke filluar nga ligat në të gjitha grupmoshat e deri tek ekipet përfaqësuese, pastaj rreth projekteve për përmirësimin e infrastrukturës në partneritet me UEFA-n e FIFA-n, por edhe institucionet shtetërore, si dhe rreth projekteve të ndryshme për zhvillimin e futbollit të të rinjve, femrave dhe të gjitha etniteteve që jetojnë në Kosovë.
Ndërkaq ambasadori Per Strand Sjaastad u shpreh i lumtur për




sukseset e Kosovës në futboll si në Ligën e Kombeve, po ashtu edhe me rezultatet pozitive dhe paraqitjen e shkëlqyeshme në dy ndeshjet e para të këtij viti kundër Danimarkës dhe Bullgarisë. "Gjithmonë në ndeshjet që i luan Kosova jam në mesin e fansave, sepse si ish-futbollist i grupmoshave të reja në Norvegji e shijoj më shumë suksesin tuaj në mesin e tifozëve. Përkrahja ime për ju dhe institucionin që ju e drejtoni do të jetë e vazhdueshme, sepse po i jepni kënaqësi dhe krenari popullit tuaj dhe jo rastësisht jeni storie e suksesit jo vetëm në Kosovë, por edhe në UEFA e FIFA", ka theksuar me këtë rast ambasadori Sjaastad.
Në fund të takimit kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ia ndau ambasadorit norvegjez si dhuratë një fanellë të Kombëtares së Kosovës si dhe një pllakate me stadiumin "Fadil Vokrri", duke e falënderuar që çdoherë është i pranishëm në ndeshjet e Kosovës dhe po i jep përkrahje futbollit tonë.

# Mbappe: Krahasimi me Pelen është i tepërt

**Paris, 3 prill** - Sulmuesi Kylian Mbappe është në gjurmët e emrave më të mëdhenj në historinë e futbollit. Mbappe shënoi më shumë se një herë në Botërorin e Rusisë, madje e gjeti rrjetën në finale, duke përsëritur skenarin e realizuar më parë nga ikona Pele në moshën 17-vjeçare. Sukses që Pele e përsëriti më pas edhe dy herë të tjera. Gjithsesi, sot 20-vjeçari Mbappe ka ende shanse që të luajë edhe në tre Kupa të tjera të Botës me Francën e tij. Mbappe dhe Pele u takuan në Paris, ku legjenda braziliane, tashmë 78-vjeç, ka thënë se "ylli" në ngjitje francez mund ta arrijë rekordin e tij të golave. "Pa diskutim që Mbappe ka aftësinë të shënojë 1000 gola, unë realizova




1025 në karrierë dhe ai mund ta bëjë diçka të tillë. Nuk e njihja Mbappenë, por kur njerëzit me thoshin se ai është 'Pele i ri' sigurisht që ishte një kënaqësi shumë e madhe. I uroj shumë fat jo vetëm si lojtar por edhe me shokët e skuadrës. Duhet fat edhe që të kesh një skuadër të mirë në krah", ka deklaruar Pele.
Mbappe, i cili ka shënuar 32 gola në të gjitha kompeticionet deri më tani, u shpreh se ndihej shumë i lumtur nga prania dhe takimi me Pelen dhe nga krasimi që i bëjnë me të. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që jam pranë tij, është një takim që do të mbetet në kujtesën time. Ai është një legjendë e gjallë e futbollit, mendoj se krahasimet me të janë të tepërta për mua, ka vetëm një mbret këtu dhe ai është ulur pranë meje. Jam thjesht Mbappe, po mundohem të bëj më të mirën për veten, skuadrën dhe kombëtaren time", ka deklaruar Mbappe. Takimi i brezave të futbollit në Paris u mbyll me fjalën e Peles, i cili beson shumë te potenciali i Mbappesë. Ai tha se talenti francez është i destinuar për të bërë gjëra të mëdha dhe të fitojë të gjitha trofetë kolektive apo edhe ato individualë.

# Golden State ruan kreun, Westbrooki barazon rekordin 50-vjeçar

